

MONITORIMI I PROCESIT TË EUROINTEGRIMEVE:

---

**REFORMAT NË ADMNISTRATËN PUBLIKE**

# "ADMINISTRIMI" I ADMINISTRATËS

---

PARAKUSHT KYÇ PËR REFORMAT

**METAMORPHOSIS** 

Fondacion për internet dhe shoqëri

## TITULLI ORIGINAL:

Следење на процесот на евроинтеграции - Реформи во јавната администрација - „Администрирањето“ со администрација, клучен предуслов за реформите

## BOTUES:

Metamorfozis - Fondacioni për Internet dhe Shoqëri,  
Rr. Apostoll Gusllarot, nr.40, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut  
www.metamorphosis.org.mk  
info@metamorphosis.org.mk  
tel/faks: +389 2 3109 325

## PËR BOTUESIN:

Bardhyl Jashari (Бардил Јашари)

## AUTOR:

Teofill Bllazhevski (Теофил Блажевски)

## REDAKTOR:

Goran Rizaov (Горан Ризаов)

## PËRKTHYES PREJ MAQEDONISHTES NË SHQIP:

Valon Abdiu

## DIZAJNI:

Dushan Stojkoviq

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје  
35.071.2(497.7)(047.31)

BLLAZHEVSKI, Teofill

Monitorimi i procesit të eurointegritimeve [Електронски извор].  
reformat në administratën publike "Administrimi" i administratës parakusht kyç për reformat / [autor Teofill Bllazhevski ; përkthyes prej maqedonishtes në shqip Valon Abdiu]. - Shkup : Фондација Метаморфозис,

2022

Начин на пристапување (URL):

<https://metamorphosis.org.mk/wp-content/uploads/2022/04/sledenje-na-procesot-naevrointegracii-reformi-vo-javnata-administracija-%E2%80%9Eadministracija-vo-administracija-kluchenpreduslov-vo-reformite.pdf>.

- Превод на делото: Следење на процесот на евроинтеграции : реформи во јавната администрација "Аминистрирањето со администрацијата" клучен предуслов за реформите. - Текст во PDF Формат, содржи 31 стр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 08.06.2022. - Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-263-076-2

а) Јавна администрација -- Реформи -- Македонија -- Истражувања

COBISS.MK-ID 57561861

# PËRMBAJTJA

Rreth projektit dhe metodologjisë -----	4
Përmbledhje -----	4
Korniza strategjike dhe ligjore -----	5
Ekziston korniza ligjore, ndryshimi është i ngadalshëm -----	6
Zbatimi -----	6
Krijimi politikave dhe koordinimi -----	8
VNR dhe ligjet me flamur evropian -----	8
Shërbimi publik dhe menaxhimi i burimeve njerëzore - sistemi i meritave varet nga ligjet -----	9
Depolitizimi i administratës - Ligji për Shërbimin e Lartë Menaxhues -----	9
LNA dhe LPSP - disa probleme -----	10
Sistemi i rrogave duhet të reformohet -----	11
Vlerësimi i administratës vetëm në letër -----	11
Ka Kode - ai për administratën nuk është zbatuar? -----	12
Kontrollohet numri i punësimeve në sektorin publik - mbetet dyshimi se sa real është -----	13
Llogaridhënia me probleme, transparenca tradicionalisht e mirë -----	14
Riorganizimi i organeve dhe institucioneve ende vetëm në letër -----	15
Transparenca dhe hapja përparojnë mirë -----	17
Transparenca financiare - pagesat ditore nga Thesari -----	18
Shërbimet e administratës - shumë hapësirë për përmirësim -----	19
Shërbimet elektronike digjitale, gjendja aktuale -----	20
Shërbimet digjitale të vetëqeverisjes lokale -----	22
Digjitalizimi i të gjithë administratës dhe financave/buxhetit për reforma -----	22
Procesi i reformës në fushën e të drejtave themelore deri në fund të marsit të vitit 2022. -----	24
KPMD ka kërkuar një buxhet deri në 730 mijë euro, mirëpo ka marrë më pak se 250 mijë -----	26
Avokati i Popullit me rreth 3.000 parashtresa për vitin 2021. -----	26
Reduktim i përhershëm i buxhetit - tendencë ndaj institucionit të AP-së? -----	27
Procesi i reformës në fushën e drejtësisë, situata deri në fund të marsit të vitit 2022 -----	28
Digjitalizimi shtyhet përpara sistematikisht -----	29
Procesi i reformës sektorin mediatik deri në fund të marsit të vitit 2022. -----	30

Reformat në fushën e administratës publike mund të vlerësohen në dy mënyra, ngjashëm sikurse vlerësimi i dyfishtë për një gotë gjysmë të mbushur me ujë. Prandaj, mund të thuhet se reformat po zhvillohen relativisht mirë, por edhe relativisht keq, ndërsa në terma kohorë relativisht shpejt, por edhe relativisht ngadalë. Se nga cila anë do të rëndojë vlerësimi varet nga vullneti politik, zbatimi, por edhe burimet financiare që akordohen për reformat e administratës. Një kategori shtesë për të cilën flitet pak janë potencialet për zbatim, nga pikëpamja profesionale, por edhe nga aspekti i motivimit brenda vetë administratës. Konkluzioni i përgjithshëm do të ishte se nëse e krahasojmë situatën me vitin 2018, kur u miratua Strategjia për Reforma, situata është dukshëm më e mirë, por rezultatet janë shumë më të dobëta se sa mund të ishte arritur nëse "administrimi" i reformave do të zbatohet me kapacitet të plotë.

**Autor: Teofil Blazhevski**

## RRETH PROJEKTIT DHE METODOLOGJISË

Dokumenti është rezultat i një hulumtimi të kryer në kuadër të projektit **"Promovimi i logaridhënies dhe transparencës së reformave publike"**, të cilin e zbaton Fondacioni për Internet dhe Shoqëri - Metamorfozis nga Shkupi, me mbështetjen e Fondacionit Kombëtar për Demokraci nga SHBA-të. Projekti zbatohet gjatë viteve 2021 dhe 2022.

Aktivitetet e projektit synojnë të paraqesin fakte të përkthyer në tekste gazetareske nga zhanre të ndryshme, analiza dhe konkluzione nga debatet publike për nivelin e aktiviteteve reformuese dhe arritjeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut në disa fusha kyçe, të cilat janë theksuar edhe në raportet e progresit të BE-së për RMV-në, në rrugën drejt integritimit në BE. Këto fusha kryesore janë: **reformat në fushën e administratës publike, gjyqësorit, të drejtave themelore të qytetarëve dhe lirisë së shprehjes/mediave.**

Në kuadër të projektit përgatiten katër raporte monitorimi (tremujore), të cilat, të udhëhequra nga një metodologji cilësore, do të vlerësojnë situatën në fushat konkrete, dhe në këtë mënyrë do të japin një pasqyrë të situatës me demokracinë në vend.

Çdo raport monitorimi trajton më hollësisht një nga katër fushat kryesore dhe ofron një përmbledhje të shkurtër të ndryshimeve në tre fushat e tjera. Raporti i parë i monitorimit i referohej zbatimit të reformave në sektorin e mediave. I dyti ka të bëjë me reformat në drejtësi, ndërsa i treti ka të bëjë me reformat në administratën publike.

Metodologjia që është e rëndësishme për këtë raport mbështetet në tre shtylla: (1) hulumtimi në zyrë, (2) artikujt gazetareskë nga gazetarë dhe redaktorë në projektet mediatike të Fondacionit "Metamorfozis", (3) intervista me ekspertë të fushës të kryera përmes fokus grupeve, të cilat janë të njohur për donatorin dhe Fondacionin "Metamorfozis", por për shkak të dëshirës për të shmangur çdo shqetësim apo konflikt të mundshëm në fushat ku ata punojnë (për shkak se bashkëpunojnë si me organizatat qeveritare ashtu edhe me ato joqeveritare dhe mediat), ata nuk do të emërtohen edhe në këtë raport. Gjithashtu janë shfrytëzuar edhe informacionet e marra nga bisedat joformale me ekspertë të tjerë, gazetarë apo reagime publike të vërejtura gjatë vitit..

Krahas intervistave, ekspertët plotësojnë gjithashtu edhe një pyetësor anketues, ku renditen dhjetëra pyetje nga fusha, i cili ofron një krahasim të kryqëzuar - për të nxjerrë një vlerësim nga pyetësi dhe për ta krahasuar atë me vlerësimet e marra nga intervistat dhe hulumtimi, në zyrë.

## PËRMBLEDHJE

**Nga hulumtimi për gjendjen e reformave të administratës publike në periudhën nga mesi i vitit 2021 deri në fund të marsit 2022, për qëllimet e këtij raporti mund të nxirren konkluzionet e përgjithshme të mëposhtme:**

- Ekziston një kornizë strategjike, mekanizëm i planifikimit strategjik dhe plane aksionale dhe këto kategori janë të vendosura në mënyrë stabile. Shtrohet çështja e vlerësimit të jashtëm cilësor të strategjive dhe detyrave të kryera nga planet aksionale, i cili edhe pse është paraparë, të paktën për Strategjinë kryesore për Reforma të AP 2018-2022, ende nuk është zbatuar. Sa i përket kornizës ligjore, ajo gjithashtu është mbuluar në mënyrë solide, por dy ligjet kryesore që e rregullojnë punën e administratës publike dhe punonjësve të sektorit publik në përgjithësi, janë në proces ndryshimesh prej një viti dhe për shkak të

përmasave të ndryshimeve, konsiderohen si propozim-zgjidhje të reja ligjore - janë vonuar. Njëri prej tyre për nëpunësit administrativë u dërgua në Kuvend në fund të marsit.

- Problem i veçantë sa i përket kornizës ligjore është miratimi i Ligjit për Shërbimin e Lartë Menaxhues, i cili është duke u harmonizuar dhe përgatitur prej tre vitesh, por asnjëherë nuk ka ardhur në seancë të Qeverisë për t'u miratuar dhe për të kaluar në procedurë në Kuvend. Problem tjetër është edhe harmonizimi/ndryshimi i mbi 200 ligjeve për të mundësuar procesin e ofrimit të shërbimeve elektronike për qytetarët, por edhe për të përshpejtuar procesin e digjitalizimit të administratës.

- Vlerësimi i ndikimit rregullator - një pjesë integrale e procesit legjislativ - është ende problem, i cili dallohet si më i mirë apo më i keq nga ligji në ligj.

-Efikasiteti i administratës mbetet problem. Megjithëse zgjidhjet ligjore ekzistuese përfshijnë modele për matjen e efikasitetit, kjo zbatohet në mënyrë formale. Kështu, në njëfarë mënyre ka ngecur sistemi i rrogave, i cili sipas angazhimeve të pushtetit ekzekutiv duhet të ndryshohet dhe ato duhet të rriten, por në të njëjtën kohë e theksojnë efikasitetin dhe matjen e atij efikasiteti në administratë.

-Llogaridhënia mbetet problem që duhet zgjidhur me riorganizimin e organeve të administratës shtetërore. Procesi i ndryshimit të Ligjit për Organizimin e Organeve të Administratës Shtetërore mbetet i hapur dhe i pasigurt, duke qenë se përkundër asistencës së ekspertëve që ka ardhur nga BE-ja, nuk ka kontribuar në progres të dukshëm dhe harmonizim të pikëpamjeve. Një problem shtesë është mospërfshirja relative, pasi shoqëria civile qëndron larg informacionit për këtë proces. Sipas të gjitha njohurive të kryqëzuara, me gjasë kjo do të bhet në mënyrë të pjesshme dhe hap pas hapi, përmes projekteve pilot dhe institucioneve pilot edhe atë gjatë këtij viti.

- Transparenca ka qenë tradicionalisht fusha më e mirë e reformave prej disa vitesh, falë zgjidhjeve ligjore dhe vullnetit politik. Megjithatë, duhet pasur parasysh se ky është një proces që duhet "kultivuar" vazhdimisht, sepse hapja është një proces luhatës. Transparenca është më e lartë në pushtetin ekzekutiv dhe legjislativ dhe me zbritjen në vertikale të pushtetit, duke i përfshirë edhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, përqindja shënon rënie. Një perlë e veçantë është transparenca financiare, e cila arrihet më së shumti përmes portalit për financa të hapura.

- Shërbimet e administratës janë përmirësuar pjesërisht. Portali përmes të cilit ofrohen shërbimet elektronike për qytetarët në 24 muajt e fundit ka rritur ofertën nga 50 në 184 shërbime plotësisht elektronike dhe për këtë vit janë duke u përgatitur rreth 40 shërbime të reja. Megjithatë, mbeten disa çështje të pazgjidhura. Formimi i identitetit digjital të qytetarëve, edukimi digjital i qytetarëve, masivizimi i nënshkrimit elektronik dhe së fundi zbatimi, gjegjësisht trajnimet e administratës për pranimin e plotë të e-dokumenteve që i marrin qytetarët nga institucionet. Në të gjithë procesin e shërbimeve elektronike, problematike mbetet rritja e numrit të shërbimeve të tilla në njësitë e vetëqeverisjes lokale.

Shërbimet elektronike dhe digjitalizimi i administratës janë procese plotësuese. Tek ekspertët ekziston një dilemë nëse digjitalizimi mund të bëhet në një kohë relativisht të shkurtër duke e centralizuar procesin - nga furnizimet e nevojshme publike e deri te edukimi i administratës apo kjo duhet bërë gradualisht. Aktualisht, digjitalizimi dhe shërbimet elektronike po shtyhen intensivisht në drejtësi, veçanërisht në gjyqësor.

Në fund, edhe pse ka pikëpamje të ndryshme për numrin e nëpunësve dhe punonjësve në sektorin publik, si faktorë vendimtarë paraqiten atmosfera dhe cilësia e të punësuarve në administratën shtetërore, e jo numri i tyre. Dhe të gjitha burimet që janë konsultuar për këtë raport tregojnë se atmosfera nuk është në nivele të lakmueshme (në një pjesë të madhe kjo është edhe për shkak të rrogave të ulëta) dhe se ka problem në përmbushjen e detyrave si në aspekt të kohëzgjatjes së procesit, ashtu edhe në aspekt të cilësisë së detyrave të kryera.

## KORNIZA STRATEGJIKE DHE LIGJORE

Ka strategji dhe ligje mbi të cilat zhvillohet një proces i vazhdueshëm i reformës së administratës publike. Këto janë dy dokumente themelore në fushën e planifikimit strategjik, përkatësisht Strategjia e RAP 2018-2022 dhe Plani Aksional i Reformës së AP 2018-2022.

Përveç kësaj, ekzistojnë edhe dokumente të tjera strategjike, siç është Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Dhënat e Hapura, si dhe disa dokumente strategjike dhe plane të veprimit të Ministrisë kompetente të Shoqërisë Informatikee dhe Administratës (MSHIA), kurse të gjitha reformat duhet të mbikëqyren nga një organ i centralizuar i quajtur Këshilli për reforma në AP, i formuar në dhjetor të vitit 2017, me ç'rast

raporti i fundit për seancat e mbajtura në ueb-faqen e qeverisë daton për seancën e tetë, nga dhjetori i vitit 2021.

Ajo që mungon apo vonohet në këtë pjesë të strategjive dhe planifikimit strategjik, sipas ekspertëve me të cilët biseduam në kuadër të fokus grupit, është vlerësimi i cilësisë së strategjive dhe zbatimi i tyre në përgjithësi. Një vlerësim i tillë i jashtëm është paraparë, sidomos për strategjinë kryesore për reformën e AP-së, por procesi është vonuar dhe supozohet se kjo është për shkak të ndryshimit të qeverisë dhe emërimit të ministrit të ri në MSHIA. Sa i përket vlerësimeve gjashtëmujore dhe vjetore të bëra nga MSHIA-ja së bashku me institucionet tjera kompetente, sipas ekspertëve të fokus grupit, bëhet fjalë për një vlerësim të thjeshtë statistikor për atë se sa nga masat dhe detyrat sipas Planit Aksional janë realizuar, e jo për një vlerësim cilësor të ndryshimeve të bëra. Duke parë efektin sasior të të gjitha raporteve të deritanishme, dhe duke qenë se Plani Aksional dhe vetë strategjia kanë një afat kohor deri në vitin 2022, një ekspert vlerësoi se do të ishte mirë që 60 për qind e detyrave të parashikuara në plan të arriheshin, në mënyrë të përmbledhur për të 4 nënfushat reformuese të Reformës së Administratës Publike.

## EKZISTON KORNIZA LIGJORE, NDRYSHIMI ËSHTË I NGADALSHËM

Ligjet që e rregullojnë punën e administratës ekzistojnë dhe kanë qenë, por edhe vazhdojnë të jenë, objekt i ndryshimeve të pjeshme, plotësimeve apo ndryshimeve të plota. Megjithatë, këto përmirësime në zgjidhjet ligjore janë më të ngadalta se sa pritej. Tri zgjidhjet kryesore ligjore për punën e administratës janë Ligji për të Punësuarit në Sektorin Publik (LPSP), Ligji për Nëpunësit Administrativë dhe Propozim-zgjidhja ligjore për shërbimin e lartë menaxhues (LSHLM). Dy të parat janë miratuar në vitin 2014, pas së cilës të gjitha aktet për sistematizim dhe organizim në shërbimet publike duhet të dorëzohen për miratim në MSHIA. Ligji i tretë nuk ka hyrë asnjëherë në fuqi deri më tani, gjegjësisht ai nuk u dorëzua asnjëherë në Kuvend, megjithëse ideja për zhvillimin e tij u shfaq në vitin 2019 dhe u promovua nga ministri i atëhershëm i Shoqërisë Informatike dhe Administratës. Në vitin 2019 janë miratuar edhe tre ligje të reja që janë të nevojshme për digjitalizim, gjegjësisht për shërbimet elektronike që administrata duhet t'ua ofrojë qytetarëve.

Një nga problemet kryesore që mund të konstatohet në kornizën ligjore është edhe Ligji për Organizimin dhe Punën e Administratës Shtetërore (LOPASH), i cili si domosdoshmëri e një zgjidhjeje të re ligjore është theksuar edhe në raportin e fundit të BE-së për RMV-në edhe atë si një nga tre prioritetet në periudhën e ardhshme dhe si fjali e parë në pjesën e Llogaridhënia e administratës<sup>1</sup>.

## ZBATIMI

Ministritë kyçe për zbatimin e reformave janë Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës (MSHIA) dhe Ministria e Financave (MF), e cila, nga ana tjetër, është përgjegjëse për zbatimin e transparencës financiare dhe racionalitetit në krijimin e politikave buxhetore. Reforma e administratës publike e vitit 2017 po zbatohet shumë më sistematikisht se më parë. Për këtë qëllim është formuar një Ekip për reforma në MSHIA, Sekretariatit për RAP, i cili i përgatit dhe i shqyrton pikat për të cilat debaton Këshilli për Reforma të Administratës Publike (KRAP), i kryesuar nga Kryeministri i RMV-së.

Këshilli, [i formuar në dhjetor 2017](#), takohet rregullisht nga viti 2018. Që atëherë, për shembull, daton edhe [ideja e rregullimit të shërbimit të lartë menaxhues](#), gjegjësisht e rregullimit të tij me ligj të posaçëm, i cili ende nuk ekziston. Në seancën e shtatë të Këshillit në dhjetor 2019, u bisedua edhe për koordinimin e procesit të analizës funksionale horizontale, për riorganizimin dhe optimizimin e organeve, agjencive dhe shërbimeve të inspektimit të administratës shtetërore. E njëjta temë dominon edhe [në mbledhjen e parafundit të 8-të të Këshillit nga dhjetori i vitit 2020](#). Në fund të mbledhjes, i cili u mbajt në dy pjesë, [kryeministri i atëhershëm Zaeu](#) përfundoi me sa vijon: **“Reforma në administratën publike është një objektiv strategjik i Qeverisë dhe është detyrimi ynë ndaj Bashkimit Evropian, por mbi të gjitha, ndaj qytetarëve tanë. Plani është që deri në fund të marsit 2021, në koordinim me të gjitha ministritë, të harmonizohen të gjitha propozimet dhe vërejtjet për propozim-ndryshimet e Ligjit për Organizimin dhe Punën e Organeve të Administratës Shtetërore, në mënyrë që Ligji të miratohet nga Kuvendi deri në fund të muajit korrik”**. Projekti për

1- KE - Raporti për Maqedoninë e Veriut për vitin 2021 - Tetor 2021 - fq. 15 dhe fq. 19 - (në dispozicion në <https://www.sep.gov.mk/data/file/Pregovori/North-Macedonia-Report-2021-MK2.pdf>)

riorganizimin dhe optimizimin e organeve të administratës shtetërore zbatohet aktivisht prej më shumë se 2 vitesh me fondet IPA, por nuk ka progres të madh.

E dhëna e fundit [për takimin e KRAP-së është nga korriku 2021](#), kur u prezantua "Raport i integruar për strukturën e ardhshme organizative të organeve të administratës shtetërore, agjencive dhe shërbimeve të inspektimit në nivel qendror", si pjesë e projektit "Mbështetje për riorganizimin shtetëror". **"Si konkluzion i takimit ishte se në periudhën e ardhshme do të finalizohet Propozimi për strukturën e ardhshme organizative të organeve të administratës shtetërore, agjencive dhe shërbimeve inspektuese në nivel qendror dhe do të dorëzohet në seancë të Qeverisë."**

Edhe pse, siç mund të shihet, ka pasur konkluzione që në mars 2021 për riorganizimin e administratës shtetërore, deri në mars 2022 nuk ka rezultate.

Vetë implementimi zbatohet sipas Planit Aksional, i cili tashmë është ndryshuar një herë në vitin 2019 dhe rishikohet vazhdimisht për sa i përket funksionalitetit të tij, gjegjësisht mundësisë së zbatimit. Për disa sektorë të reformave, e të cilat zgjidhen në katër fusha kryesore, miratimi i ligjeve bazë është vendimtar, në këtë rast ndryshimet e përmendura në LPSP, LN dhe miratimi i LShLM-së. Këto dispozita janë veçanërisht të rëndësishme për zbatim në sektorin e Shërbimit publik dhe menaxhimit të burimeve njerëzore.

Suksesi i zbatimit të deritanishëm vlerësohet i moderuar, megjithëse në disa fusha është më i lartë. Vlerësimet i jep edhe vetë MSHIA-ja në raportet tremujore dhe vjetore për zbatimin e RAP-it, pastaj nga organizatat ndërkombëtare si p.sh. BE-ja apo institucionet e financuara prej tyre, si ajo e OBEZh-it dhe BE-së, Iniciativa SIGMA. Raportet vjetore dhe tremujore ndonjëherë vonohen. Për shembull, për vitin 2021 ai raport në mars të vitit 2022, ende nuk është publikuar, ndërsa sipas tij për performancën në vitin 2020 mund të arrihet një vlerësim i përgjithshëm prej rreth 18% të përmbushjes së aktiviteteve në katër fushat sektoriale ku zbatohen reformat (Hartimi i politikave dhe koordinimi, Shërbimi publik dhe menaxhimi i burimeve njerëzore, Përgjegjësia, llogaridhënia dhe transparencja dhe Ofrimi i shërbimeve dhe mbështetja me TIK për AP-në). "Nga gjithsej 108 aktivitete për të cilat është raportuar në periudhën janar - dhjetor 2020, 19 aktivitete janë realizuar plotësisht, 24 aktivitete janë në zhvillim e sipër, ndërsa 65 aktivitete kanë gjece në realizim. Korniza e përcaktuar kohore për vitin 2020 është realizuar 18% "<sup>2</sup>.

Sipas [draft raportit gjashtëmujor për vitin 2021](#), realizimi i përgjithshëm i aktiviteteve për sa i përket realizimit të plotë është vetëm 10 për qind (5 nga 51 aktivitete), dhe nëse marrim parasysh edhe aktivitetet që ishin në zbatim, përqindja është rritur në 53 për qind të aktiviteteve.

Sipas të njëjtit dokument, i cili tregon përqindjen e realizimit të **Planit aksional për periudhën janar 2018 - qershor 2021, 48% e aktiviteteve janë realizuar, 12% ishin në realizim e sipër dhe 40% kishin vonesë në realizim**<sup>3</sup>.

Sipas Raportit të Monitorimit të SIGMA-s të nëntorit 2021, RMV-ja ka bërë progres në 4 fusha, duke i krahasuar me vitin 2017 dhe me situatat në rajon, ndërsa në dy fusha, janë nën mesataren e rajonit. Është bërë përparim në kornizën strategjike për reformën e administratës dhe në llogaridhënien dhe ofrimin e shërbimeve, ndërkohë që vendi mbetet prapa mesatares rajonale për sa i përket Hartimit të politikave dhe koordinimit dhe në Shërbimin publik dhe burimet njerëzore.

Vlerësimi i përgjithshëm i shprehur në përmbledhjen ekzekutive të këtij raporti për RMV-në në vitin 2021, krahasuar me vitin 2017, është se "është bërë progres i dukshëm në fillimin e reformave të ndryshme në fushën e administratës, ndërkohë që zbatimi ka qenë i kufizuar, pasi më pak se gjysma e aktiviteteve të planifikuara në nivel vjetor zbatohen"<sup>4</sup>.

2 - Raporti vjetor i KRAP-së së për vitin 2020 - fq. 5 - (në dispozicion në [https://mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl\\_files/documents/reports/izveshtaj\\_za\\_srja\\_za\\_2020\\_godina.pdf](https://mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl_files/documents/reports/izveshtaj_za_srja_za_2020_godina.pdf))

3 - Raporti i katërt gjysmëvjetor për zbatimin e PA për RAP - qershor 2021 -fq.14- (në dispozicion në [https://mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl\\_files/documents/rja/nacrt\\_-\\_chetvrt\\_polugodishen\\_izveshtaj\\_za\\_srja.pdf](https://mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl_files/documents/rja/nacrt_-_chetvrt_polugodishen_izveshtaj_za_srja.pdf))

4 - SIGMA - nëntor 2021 - Raporti i Monitorimit - fq.8 - (është në dispozicion në <http://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Republic-of-North-Macedonia.pdf>)

## KRIJIMI POLITIKAVE DHE KOORDINIMI

Histori të suksesshme, sipas vetë MSHIA-së në raportin gjashtëmujor, janë përpjekjet e Sekretariatit të Përgjithshëm (SP) të Qeverisë për të prezantuar masat për ngritjen e kapaciteteve për planifikimin afatmesëm sektorial dhe vjetor, si dhe për monitorimin dhe raportimin dhe vlerësimin e politikave.

SP-ja së bashku me përfaqësues të ministrive dhe institucioneve të tjera (Ministrisë së Financave, MSHIA-së, Sekretariatit për Çështje Evropiane - SÇE dhe Sekretariati për Legjislacion - SL), përgatiti një sërë dokumentesh si draft-udhëzime, formularë dhe dokumente të tjera të dedikuara për organet e administratës shtetërore për mënyrat e planifikimit strategjik, strategjitë sektoriale, raportimin për to e të ngjashme.

Një kontribut i madh për vitin 2021 në këtë pjesë të reformave është edhe Regjistrimi i popullsisë i realizuar me sukses në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore të miratuara më parë.

Përveç kësaj, SP-ja publikoi edhe një plan strategjik për zhvillimin e saj për periudhën 2021-2023, i cili mund të shihet në [KËTË](#) link.

Shikuar formalisht, në këtë segment reformash të quajtur Hartimi i Politikave dhe Koordinimi, janë disa dokumente të nevojshme: rregulloret e punës dhe rregulloret, metodologjitë, planet operacionale dhe udhëzimet dhe të gjitha ato janë të disponueshme publikisht edhe në faqen e internetit të QRMV-së në një [link të veçantë](#). Problemi është ripërtirja e tyre dhe përmirësimi i teksteve dhe kjo është duke u bërë ose është planifikuar të bëhet në përputhje me Planin Aksional për RFA. Si shembull mund të përmendet [Doracaku i Planifikimit Strategjik](#), i cili është i vitit 2014.

Nga bashkëbisedimi me ekspertët në fokus grup, mund të konstatohet se për sa i përket kornizës strategjike dhe ligjore, ekziston koordinimi gjatë hartimit të politikave. Planifikimi strategjik tashmë është krijuar, ka mekanizma për plane strategjike dhe plane për zbatimin e tyre. Këto punë drejtohen dhe koordinohen nga Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë, nëpërmjet njësive apo sektorëve të planifikimit strategjik në kuadër të ministrive dhe më poshtë vertikalisht në të gjitha institucionet e administratës shtetërore, të cilat janë përgjegjëse për të pasur dokumente të tilla në lidhje me punën e tyre. Ekspertët, megjithatë, theksojnë se si do të zhvillohet i gjithë procesi varet nga institucioni në institucion dhe cilësia e personelit që e kanë në dispozicion. Përveç kësaj, sipas ekspertëve të fokus grupit, mund të jetë mangësi që përgatitja dhe obligimi për përgatitjen e strategjive nuk vërehet askund si obligim i veçantë, por janë nxjerrë nga Ligji për Qeverinë.

Si problem që lind në këtë pjesë, hartimi i politikave, është qeverisja apo udhëheqja e mirë. Për shembull, në periudhën nga tremujori i parë i këtij viti, shtrohet pyetja se çfarë mekanizmi duhet të vendoset në kontrollin e shpenzimit të parave publike dhe funksionimin e institucioneve sipas ligjit, për të cilin gjë në masë të madhe është përgjegjës Enti Shtetëror i Revizionit. Problemi kryesor është në çështjen se çfarë shqyrton dhe kush duhet të veprojë sipas raporteve dhe gjetjeve të këtij institucioni. Sipas mendimit të njëjtë të kreut të ESHR-së dhe Zëvendëskryeminstres përgjegjës për politikën e qeverisjes së mirë, Kuvendi duhet të përfshihet shumë më aktivisht në shqyrtimin e të paktën raporteve kyçe të ESHR-së, por përveç kësaj, duhet të ketë një mekanizma brenda qeverisë dhe ministrive, për të vepruar shpejt në bazë të gjetjeve të ESHR-së, nëse institucionet janë inerte dhe nuk veprojnë në bazë të vërejtjeve<sup>5</sup>.

## VNR DHE LIGJET ME FLAMUR EVROPIAN

Vlerësimi i Ndikimit Rregullator (VNR) mbetet një sfidë, siç janë edhe dokumentet e tjera të nevojshme për të ngritur cilësinë e rregulloreve. Sipas ekspertëve nga fokus grupi në VNR, për shembull, varet nga ligji në ligj. Në nivel sasi, mbetet shifra që rreth 75% e rregullativës është e mbështetur me VNR deri në nivelin bazë të VNR cilësore, por shikuar individualisht, në disa ndryshime ligjore të propozuara apo ligje krejtësisht të reja, pjesa e quajtur vlerësimi i ndikimit është bërë shumë mirë, e në disa të tjera ai është futur vetëm formalisht. Ende mbetet problemi me procedurat, siç është ai për shembull se në ndryshimin urgjent të një rregulloreje nuk nevojitet VNR e as nëse zgjidhja ligjore propozohet nga deputetët, gjë që është e pakuptueshme për ekspertët. Për ta bërë më të qartë, ky problem u vu re në vitin 2017, kur u bë

5 - TV "Telma" - "Top Tema" - 22.02.2022 - Si shpenzohen paratë publike- (në dispozicion në [https://www.youtube.com/watch?v=9y\\_dvdhg3cY&t=2s](https://www.youtube.com/watch?v=9y_dvdhg3cY&t=2s))



një analizë e quajtur "Sfidat dhe rekomandimet për përmirësimin e procesit legjislativ". Në atë analizë të mbështetur nga NDI, në lidhje me VNR-në, thuhet:

“Zbatimi i vlerësimit të ndikimit përgatitet shumë shpesh pasi propozimi legjislativ është përgatitur dhe nuk është rezultat i një analize të plotë. Propozimi ligjor nuk përgatitet në drejtim të opsionit të preferuar nga vlerësimi i kryer i ndikimit. Formularët fiskalë plotësohen formalisht, pa një paraqitje objektive të ndikimeve financiare. “Analiza e ndikimeve sociale, ekonomike dhe ekologjike mbi politikën është formale.”<sup>6</sup>.

A kanë ndryshuar këto rrethana? Sipas mendimit të ekspertëve të fokus grupit, ka progres, por ai nuk është i kënaqshëm. Por, edhe midis ekspertëve ka ndarje. Nga fokus grupi doli se, për shembull, Drafti i ligji të ndryshuar ose të ri për npunësit administrativë në pjesën e quajtur vlerësimi i ndikimit rregullator në një pjesë “nuk ishte arsyetuar mirë dhe në mënyrë të detajuar” (një nga ekspertët) ose se “ është përgatitur shumë mirë (ekspertë të tjerë të konsultuar brenda fokus grupit).

## SHËRBIMI PUBLIK DHE MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE - SISTEMI I MERITAVE VARET NGA LIGJET

Kushti më i rëndësishëm për përparimin në sektorin e shërbimit publik dhe menaxhimit të burimeve njerëzore janë ligjet bazë në këtë fushë: Ligji për Npunësit Administrativë, Ligji për Punonjësit në Sektorin publik dhe ligji që ende nuk është përfshirë në legjislacion, Ligji për Shërbimin e Lartë Menaxhues.

Bëhet fjalë për zgjidhje ligjore që duhet të mundësojnë profesionalizimin e administratës, integritet më të mirë dhe mbrojtje nga korrupsioni dhe nepotizmi, depolitizimin e administratës dhe futja, gjegjësisht forcimi i sistemit të meritës si parim bazë për punësimin dhe avancimin në administratën publike. Bëhet fjalë për një periudhë të gjatë përgatitjesh dhe konsultimesh, duke pasur parasysh faktin se vetë MSHIA-ja në raportin gjashtëmujor për zbatimin e Planit Aksional për Reforma në AP 2018-2022, për periudhën janar-qershor 2021, thekson se "në gjysmën e parë të vitit 2021 është punuar intensivisht "për propozim-zgjidhjet ligjore për këto tre ligje. Në fund të fundit, nëse shikohet historia e ndryshimeve të fundit të [LNA](#), [LPSP](#) dhe me radhë [LSHLM](#), të cilët gjendet në portalin qeveritar për dispozitat ligjore ENER, mund të shihet se draftet në versionin e parë janë vendosur që më 17.9.2021. dhe se koha për komente ka skaduar, ndërsa Ligji Shërbimin e Lartë Menaxhues është duke u zvarritur në një proces konsultimi publik që nga marsi i vitit 2019. Kjo do të thotë se konsultimi publik ka përfunduar.

Madje, pak para mbylljes së këtij raporti, këtë e ka konfirmuar edhe ministri kompetent i MSHIA-së në një konferencë për media, duke bërë të ditur se të tre ligjet janë gati dhe të qartësuar dhe se i pari që do të dërgohet në Kuvend është LNA-ja, kurse dy të tjerët gjatë vitit.

Bëhet fjalë për dispozita krejtësisht të reja, sepse edhe në përshkrimin narrativ në ENER thuhet se ndyrshohen më shumë se 1/3 e neneve të LNA-së dhe LPSP-së, ndërsa LSHLM-ja është një propozim-ligj krejtësisht i ri, ta përsërisim, është vënë në ENER disa herë, më pas është rishikuar nga Qeveria, dhe përsëri është kthyer në ENER, etj.

## DEPOLITIZIMI I ADMINISTRATËS - LIGJI PËR SHËRBIMIN E LARTË MENAXHUES

Duhet theksuar se futja e parimit të sistemit të meritës ose punësimi dhe avancimi në shërbim ekskluzivisht sipas sistemit të meritës, varet nga zgjidhjet e përfshira në ligje dhe në ndryshimet që janë temë në institucionet e sistemit përpara se të hyjnë në fuqi. Njëkohësisht, me zgjidhjet e reja ligjore duhet të vihet një pengesë edhe për partizimin, nepotizmin dhe kronizmin, veçanërisht në shërbimin e lartë menaxhues, që ka të bëjë me LSHLM-në.

Në fund të fundit, ky është motivi kryesor i këtij ligji. Sipas ekspertëve, përveç emërimit të personave drejtues në ndërmarrjet publike, agjencitë, inspektoriatet dhe organet e tjera të administratës shtetërore,

6 - Sfidat dhe rekomandimet për përmirësimin e procesit legjislativ - 2018 - (në dispozicion në [https://www.mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl\\_files/documents/rja/zakonodaven\\_proces\\_preporaki.pdf](https://www.mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl_files/documents/rja/zakonodaven_proces_preporaki.pdf))

ai parashikoi edhe profesionalizëm në emërimin e sekretarëve, përveç institucioneve të pushtetit qendror edhe në pushtetin lokal, edhe pse në debat është shtruar pyetja pyetja nëse kjo nuk ishte ndërhyrje në vetëqeverisjen lokale. Në versionin e fundit të ligjit, megjithatë, mbeti kjo zgjidhje. Megjithatë, ligji fillimisht parashikonte që ai të zbatohet për rreth 250 pozicione drejtuese (megjithëse është konsideruar edhe përfshirja e të gjithë njerëzve në bordet drejtuese dhe mbikëqyrëse të ndërmarrjeve shtetërore dhe shoqërive aksionere shtetërore), duke e ulur kështu politizimin në shërbimin e lartë menaxhues dhe ai të zëvendësohet me kuadër profesional të përzgjedhur sipas sistemit të meritës. Një tjetër çështje kontestuese ishte se ku, në cilin institucion do të vendosen komisionet për përzgjedhjen e kandidatëve për shërbimin e lartë menaxhues. A do të vendoset në Kuvend, siç ishte planifikuar më parë në një nga ndryshimet, apo në Qeveri dhe ministri.

Sipas informacioneve që morëm gjatë përgatitjes së këtij raporti nga ekspertët dhe burime të tjera, problemi është padyshim në dy segmente - ku do të pozicionohen komisionet dhe nënkomisionet dhe zgjedhja e sekretarëve - sekretari i shtetit nëpër ministri dhe sekretarët në vetëqeverisjet lokale. Problemi i dytë me sekretarët në versionin e fundit të ligjit është zgjidhur në atë mënyrë që edhe sekretarët në komuna mbetën për t'u zgjedhur, ndërsa nuk morëm informacion se si është zgjidhur problemi me vendndodhjen e komisioneve dhe nënkomisioneve.

Sa i përket rrugës së gjatë të këtij ligji të pa miratuar, edhe pse po përgatitet që nga viti 2019, në mesin e ekspertëve dhe te mediat pothuajse nuk ka dyshim se arsyeja kryesore qëndron edhe në partizimin e shërbimit të lartë menaxhues, që vazhdimisht i nënshtrohet pazareve partiake dhe marrëveshjeve të tipit "i imi - i yti". Një shembull i kësaj mund të shihet në marrëveshjen e arritur për partner të ri të koalicionit në qeverinë aktuale, kur përveç posteve ministrore, u arrit marrëveshje edhe për poste, gjithsej pak më pak se 50 pozita drejtuese të organeve, trupave dhe institucioneve në kuadër të sistemit të pushtetit ekzekutiv, e cila u konfirmua edhe nga vetë Qeveria:

☑ Sipas marrëveshjes së arritur, Alternativa do të marrë përgjegjësinë në menaxhimin e organeve udhëheqëse dhe qeverisëse në disa institucione në nivel qendror dhe rajonal. Ndër to më të rëndësishmet janë MEPSO, Fondi për sigurim pensional dhe invalidor, transporti hekurudhor, Qendra klinike Tetovë, Agjencia për Investime të Huaja et<sup>77</sup>.

Ky dyshim për politizimin e Ligjit për Shërbimin e Lartë Menaxhues u konfirmua hapur nga të gjithë ekspertët në fokus grupin me të cilët biseduam. Sipas tyre, bëhet fjalë për vullnet politik për t'i larguar duart nga nga pozitat e menaxhmentit të lartë gjatë marrëveshjeve të koalicionit apo në zbatimin e politikave partiake nga pozita e pushtetit ekzekutiv.

## LNA DHE LPSP - DISA PROBLEME

Sa i përket ndryshimeve në LNA dhe LPSP, ekspertët që i kanë parë zgjidhjet e propozuara ligjore, dhe me të cilët kemi biseduar, kanë mendime të ndryshme. Disa prej tyre i konsiderojnë të mira. Ekspertë të tjerë thonë se kanë pasur shumë vërejtje për pjesë të LNA-së, për të cilin thonë se ka përmirësime në pjesën e sistemit të meritës gjatë punësimit (ai edhe më parë e ka mundësuar sistemin e meritës nëse zbatohet siç duhet) dhe ndryshime të vogla në aspekt të avancimit në vendin e punës, gjegjësisht vlerësimit të administratës. Mirëpo, ka pasur edhe elemente të tjera kontestuese, për të cilat sektori i shoqërisë civile ka reaguar vetëm pasi ndryshimet ishin vendosur në ENER, sepse ato nuk ishin përfshirë më parë në shkrimin e ndryshimeve të propozuara.

Kur bëhet fjalë për këto dy ligje, LNA dhe LPSP, sipas disa ekspertëve, në një pjesë bëhet fjalë për harmonizimin e dy ligjeve, ndërsa në një pjesë tjetër për përmirësimin e sistemit të punësimit, kategorizimit dhe vlerësimit të nëpunësve administrativë.

Integriteti i administratës publike në përgjithësi, për sa i përket rezistencës ndaj keqpërdorimit dhe korrupsionit, varet edhe nga departizimi, nepotizmi dhe kronizmi. Dhe këtë e kanë theksuar në mënyrë të përsëritur të gjitha subjektet vendase dhe ndërkombëtare, të cilat direkt apo indirekt janë përgjegjës apo e vlerësojnë çështjen e korrupsionit.

Sipas gjetjeve fillestare të hulumtimit, dy ligjet duhet të jenë në agjendën e Qeverisë diku në qershor të vitit 2022. Megjithatë LNA-ja është shqyrtuar dhe miratuar nga Qeveria në fund të marsit dhe është paralajmëruar se do të dërgohet menjëherë në Kuvend. [dhe një nga shpjegimet kryesore ishte](https://vlada.mk/node/27166) se është e

7 - Qeveria e RMV-së - 5.12.2021 - / Komunikatë - Shtyp / - (në dispozicion në <https://vlada.mk/node/27166>)

nevojshme të harmonizohen ndryshimet në të me ndryshimet në Ligjin për Rrogën Minimale. Mirëpo, deri në fund të marsit, LNA-ja, përkundër njoftimeve, nuk mund të gjendej në ueb-faqen e Kuvendit si legjislacion i dorëzuar për shqyrtim dhe miratim.

## SISTEMI I RROGAVE DUHET TË REFORMOHET

Rritja e fundit e rrogës minimale në vend në 18.000 denarë<sup>8</sup> e demonstroi edhe një herë nevojën për reformimin e sistemit të listës së rrogave në administratën publike. Ekziston një besim i përgjithshëm në publik se administratorët ose punonjësit e sektorit publik kanë "rrogë të lartë për punë të vogël", që mund të konstatohet vetëm duke i ndjekur të gjitha emisionet debatuëse në media ku marrin pjesë edhe qytetarët, e se rrogat në aspekt të produktivitetit janë të mjaftueshme, mund të dëgjohet madje edhe nga persona drejtues në institucionet e pushtetit qendror, siç ishte deklarata e fundit e drejtorit të FIZHT-së<sup>9</sup>. Por, edhe para kësaj, drejtues të lartë të pushtetit ekzekutiv kanë deklaruar dhe vazhdojnë të deklarojnë se kanë problem me sistemin e rrogave, veçanërisht në disa fusha të sektorit publik dhe aq më tepër me punonjësit e organeve të administratës shtetërore (rreth 16 mijë nga numri total i të punësuarve në sektorin publik), me ç'rast dhe për shkak të rrogave, kadro cilësore nga këto organe largohen nga sektori publik. Nëse kësaj ia shtojmë edhe problemin specifik me rrogat në sektorët e TI-së dhe të punonjësve në ato njësi në sektorin publik, të cilat janë pakrahueshëm më të ulëta se ato të sektorit privat, që për pasojë ka edhe interesin e ulët për punësimin e personave me një profil të tillë arsimor - është mjaft e qartë nevoja për ta ndryshuar dhe për të krijuar një sistem rrogash më efikas.

Se nevoja ndihet për këtë, tregon edhe Dekreti i Qeverisë së RMV-së nga gushti i vitit 2021, me të cilin në institucionet qendrore të pushtetit ekzekutiv kishte mundësi që 30% të të punësuarve t'u paguajnë shtesë në rrogë deri në 30% të punonjësve për shkak të vështirësisë dhe specifikës së punës.<sup>10</sup>. Zbatimi i këtij dekreti është bërë i mundur me ndryshimet në Ligjin për Ekzekutimin e Buxhetit, dhe kështu anashkalohet edhe ligji bazë për administratë - LNA, nga versioni i fundit i të cilit është hequr edhe rregullimi i mëparshëm i kompensimeve me 5 për qind të të punësuarve në AP. Megjithatë, duket se këto procedura janë ndërhyrëse, ashtu si edhe politikat për rritjen e rrogave të punonjësve në shëndetësi, falë të cilave u arrit një efekt kënaqësie, sidomos tek kadri specialist, por edhe tek personeli me përgatitje të mesme mjekësore shkollore. Në fakt, për jokonsekuencën e këtyre politikave të ndërhyrjes për rrogat e administratës shtetërore/publike, flet edhe fakti se në fillim të vitit 2022, qeveria e re miratoi sërish një Dekret që e kthen përqindjen në vetëm 5 për qind të punonjësve në institucionet shtetërore, të cilët mund të marrë shtesë të rrogës prej 30 për qind.

Pra, nuk ka një sistem të vetëm rrogash, ashtu siç nuk ka një sistem të vetëm dhe të saktë për vlerësimin e administratës dhe matjen e produktivitetit të saj. Për sa i përket rrogave, i vetmi dokument që mund të gjendet në ueb-faqen e MSHIA-së është analiza krahasuese e sistemit të rrogave, ku rekomandimi kryesor është se "në kushtet maqedonase nuk mund të lulëzojë sistemi liberal i rrogave në sektorin publik, por zgjidhja duhet të kërkohet në një dozë të përshtatshme të rregullimit dhe fleksibilitetit për shpërbllimin e nëpunësve publikë, për të siguruar një raport optimal të performancës dhe kënaqësisë së tyre me rrogat, duke arritur/ruajtur një cilësi të lartë të shërbimeve publike".<sup>11</sup>.

Kjo tregon se Qeveria e RMV-së në politikat reformuese të AP-së nuk merret në mënyrë të veçantë me këtë çështje, por e zgjidh atë në bazë të politikave të përgjithshme të programeve. Sipas informacioneve të fundit para përfundimit të këtij raporti, Qeveria insiston në harmonizimin përmes dialogut, ndërsa disa sindikata shprehin pakënaqësi dhe paralajmërojnë protesta, sepse kërkojnë përqindje më të larta të rritjes menjëherë ose në një periudhë të shpejtë, për një ose dy muaj.

## VLERËSIMI I ADMINISTRATËS VETËM NË LETËR

Megjithatë, vërejtjet e kryeministrit dhe të figurave të tjera publike për matjen e efikasitetit dhe produktivitetit të administratës dhe lidhjen e tyre me rrogat tregojnë për vëmendjen e duhur në vlerësimin

8 - Qeveria e RMV - 7.2.2022 - Komunikatë për rrogën minimale - (në dispozicion në <https://vlada.mk/node/27692>)

9 - 24 Analizë - 8.2.2022 - debat për rrogat minimale dhe rrogat e tjera, Jovan Despotovski, Drejtor i FIZHT - (në dispozicion në <https://time.mk/tv/v/C1B9zIhtYRI>)

10 - Qeveria e RMV - 7.2.2022 - Komunikatë - (në dispozicion në <https://vlada.mk/node/26151>)

11 - MSHIA / QMK - Analizë krahasuese e sistemit të rrogave në sektorin publik - (në dispozicion në [https://mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl\\_files/documents/rja/komparativna-analiza-na-sistemot-na-plati.pdf](https://mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl_files/documents/rja/komparativna-analiza-na-sistemot-na-plati.pdf))

e punës së administratës publike. Ajo pjesë është e rregulluar në përgjithësi me Ligjin për Marrëdhëniet e Punës, më hollësisht nga LNA-ja dhe në një masë më të vogël nga LPSP-ja. Në përgjithësi, nëpunësit administrativ vlerësohet dy herë në vit. Një herë në gjysmën e parë të vitit dhe një herë në fund të vitit. Në LNA ka detaje për këtë dhe një sistem notash nga 1 deri në 5.

Por, sipas ekspertëve në fokus grup, kjo funksionon vetëm në letër. Në praktikë, pikët më të larta ose më të ulëta nuk jepen kurrë dhe ka shumë arsye për këtë. Një nga arsyet është afërsia, gjegjësisht fakti që punonjësit nuk duan t'i prishin raportet me njëri-tjetrin. Së dyti, askush nuk do të guxonte t'i jepte notën më të ulët dikujt që është pranuar me ndërhyrje (partiake, familjare, apo ndonjë ndërhyrje tjetër), sepse ka frikë nga hakmarrja. LNA-ja e re parashikon gjithashtu futjen e fletëve evidentuese me të cilat do të përmirësohej sistemi i vlerësimit dhe i matjes së produktivitetit, tha njëri nga ekspertët.

**“Nëse vërtet dëshironi të matni produktivitetin, kjo është shumë e thjeshtë duke u bazuar në një formulë të njohur - numri i detyrave të caktuara pjestëuar me numrin e detyrave të kryera dhe shumëzuar me njësinë e kohës”, thotë njëri nga ekspertët e fokus grupit. Mbeten detajet të tjera, siç është vlerësimi cilësor i detyrave të kryera. Por, pyetja e madhe është nëse ka motiv dhe kushte që kjo të zbatohet brenda administratës.”**

Sipas të njëjtit ekspert, në të njëjtin dokument, nëse ka dëshirë, mund të rishikohet edhe sistemi i rrogave. Në këtë dokument do të kishte një katalog të vendeve të punës me tabela se për cilin vend çfarë rroge është paraparë dhe si do të ndryshonte ajo sipas disa parametrave.

## KA KODE - AI PËR ADMINISTRATËN NUK ËSHTË ZBATUAR?

Një element i rëndësishëm në lidhje me integritetin janë edhe kodet e sjelljes për të gjithë në administratën publike dhe shtetërore. Është bërë përparim në këtë çështje disa vite më parë me futjen e kodeve. Në vitin 2019, Qeveria e promovoi Kodin e Sjelljes Etike për anëtarët e Qeverisë dhe bartësit e funksioneve publike të emëruar nga Qeveria<sup>12</sup>. Futja e këtij Kodi u vë në dukje edhe nga Komisioni i Venedikut gjatë vlerësimit të Rrethit të Pestë të rekomandimeve për RMV-në, në fushën e masave kundër korrupsionit, i cili u publikua në tremujorin e parë të vitit 2021.

Krahas këtij kodi, që nga viti 2014 ekziston edhe një Kod për nëpunësit administrativë<sup>13</sup>. Një ndryshim që mund të regjistrohet në periudhën për të cilën po shkruajmë (2021/2022), është se ky Kod është në ndryshim e sipër. Konkretisht, që nga prilli i vitit 2021, në portalin qeveritar për dispozitat elektronike ENER është postuar një draft version i ri i Kodit, për të cilin debati deri në mes të shkurtit ishte ende i hapur. Në përshkrimin e shkurtër thuhet se pas një vlerësimi të zbatimit të Kodit nga viti 2014, është konstatuar se duhet të përgatitet një kod i ri, që çon në pyetjen se pse nuk është zbatuar - a është kjo sepse nuk ka qenë akt nënligjor cilësor apo nuk ka pasur vullnet për respektimin e zbatimit të tij:

"Një nga angazhimet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut është kthimi i besimit në institucione, dhe nga ana tjetër, te Kodi, si akt nënligjor i miratuar në vitin 2014, nuk është bërë vlerësim për zbatimin e tij, u imponua nevoja për zbatimin e një aktiviteti të tillë që rezultoi me miratimin e një Kodi të ri të nëpunësve administrativë" - thuhet në ENER.

Edhe pse nuk janë pjesë e administratës klasike, por janë një veprimtari specifike që është pjesë e sektorit publik, Kod të Sjelljes ka dhe Ministria e Punëve të Brendshme, kod të veçantë ka edhe policia, rregulla të ngjashme etike ekzistojnë edhe në Ministrinë e Mbrojtjes, gjegjësisht: Armata etj.

12 - Kodi - Qeveria - 2019 - (në dispozicion në [https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/kodeks\\_za\\_etich-ko\\_odnesuvanje.pdf](https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/kodeks_za_etich-ko_odnesuvanje.pdf))

13 - Kodi - administrata - 2014 - (në dispozicion në [https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/zakoni/kodeks\\_za\\_administrativni\\_sluzhbenici.pdf](https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/zakoni/kodeks_za_administrativni_sluzhbenici.pdf))

## KONTROLLOHET NUMRI I PUNËSIMEVE NË SEKTORIN PUBLIK - MBETET DYSHIMI SE SA REAL ËSHTË

Për sa i përket menaxhimit të burimeve njerëzore, në funksion është sistemi [SIBNJ \(Sistemi Informatik i Burimeve Njerëzore\)](#), nëpërmjet të cilit është rrjetëzuar ose duhet të jetë i rrjetëzuar e gjithë administrata publike dhe shtetërore. Nëpërmjet këtij sistemi, *de facto* nxirret edhe regjistri i punonjësve në Administratën Publike, i cili mbahet rregullisht prej disa vitesh dhe përgatiten raportet vjetore për punonjësit në sektorin publik.

Po të ndjekim raportet për të punësuarit në pesë vitet e fundit, rezulton se të punësuarit në sektorin shtetëror dhe publik në RMV kanë mbetur në rreth 130 mijë, duke mos i përfshirë personat në shoqatat aksionare në pronësi shtetërore apo të përzier, ku qeveria është pjesë e strukturave drejtuese. Në të njëjtën kohë, në përputhje me ligjin, nuk janë shfaqur të dhënat për deputetët, ministrat, zëvendësministrat, kryetarët e komunave, kryetarët dhe anëtarët e komisioneve shtetërore, drejtorët, gjyqtarët, prokurorët publikë dhe personat e tjerë të zgjedhur apo të emëruar.

Megjithatë, sipas disa ekspertëve në fokus grupin, nuk dihet numri i personave të tjerë që llogariten qoftë edhe si punonjës të përkohshëm në sektorin publik nëpërmjet agjencive të punësimit të përkohshëm apo i atyre që kanë kontrata në vepër (kontrata me honorar), numri i të cilëve veçanërisht rritet në vitet e zgjedhjeve. Një shembull i tillë ishte hapja e kontratave të lidhura ndërmjet punonjësve të përkohshëm ose personave të tjerë nga vetëqeverisja lokale në Tetovë, ku rezultoi se bëhej fjalë për mbi 800 persona, shumë prej të cilëve nuk kishin dorëzuar dëshmi për obligimet e kryera për të cilat kishin marrë para publike. Nuk dihet numri total i personave të tillë në sektorin publik, megjithëse një pjesë e opozitës spekulon se bëhet fjalë për rreth 70 mijë persona.

Ajo që është e dhënë publike dhe e disponueshme për të gjithë publikun dhe ekspertët e fokus grupit, është Regjistri që e mban MSHIA-ja. Sipas raportit të fundit për numrin e punonjësve të sektorit publik të publikuar në mars të vitit 2021, situata paraqitet si më poshtë:

Deri më **31.12.2021**, si punonjës të sektorit publik llogariten **132.088 persona**, që punojnë në gjithsej **1.346 institucione**, me çka sektori publik u rrit për **905 persona**<sup>14</sup>.

Krahasuar me raportin e mëparshëm, do të shihni një rritje të lehtë të punonjësve, por edhe të institucioneve:

Më **31.12.2020** **131.183 persona** kanë krijuar marrëdhënie pune në gjithsej **1.332 institucione** të sektorit publik. Krahasuar me vitin 2019, numri i të punësuarve në institucionet e sektorit publik është zvogëluar për **1.717**<sup>15</sup>.

Numri i të punësuarve në sektorin ushtarak-politor-të sigurisë, i cili për vitin 2021 është **19.311 persona**, është më i ulët krahasuar me datën 31.12.2020, sepse atëherë në këto shërbime dhe institucione kanë punuar **19.594 persona**. Përndryshe, ky numër përfshihet në numrin e përgjithshëm të të punësuarve në sektorin publik, por, në përputhje me nenin 19 të LPSP-së, për ta nuk mbahet evidencë dhe analizë e veçantë në Raportin vjetor.

Sipas analizës së strukturës së të dhënave për **112.777 punonjës** në sektorin publik, **62,356** janë gra, kurse **50,421** janë burra. Mosha mesatare e këtyre punonjësve është 46.11 vjeç, për gratë mesatarja është 45.27 vjeç, ndërsa për burrat 47.15 vjeç, të dhëna që sugjerojnë se administrata publike nuk është tërheqëse për të rinjtë.

MSHIA-ja këtë vit e ka ndërprerë praktikën në katër vitet e fundit që në raporte t'i publikojë numrat e të punësuarve në SH.A. Në pronësi shtetërore dhe përmes agjencive të punësimit të përkohshëm (APP), me arsyetimin se kjo nuk është obligim ligjor për ta. Me kërkesën tonë, MSHIA-ja është përgjigjur se deri më 31.12.2021 **numri i të punësuarve në këto shoqëri është 8.918, pra është zvogëluar për 1.472 persona**.

14 - MSHIA - Raporti nga Regjistri i Punonjësve në Sektorin Publik për vitin 2021 - (në dispozicion në <https://www.mioa.gov.mk/?q=mk/node/3946>)

15 - Raporti nga Regjistri i Punonjësve në Sektorin Publik për vitin 2020 - fq.19 - (në dispozicion në [https://www.mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl\\_files/documents/reports/izvestaj\\_registar\\_2020\\_rev.1.01.pdf](https://www.mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl_files/documents/reports/izvestaj_registar_2020_rev.1.01.pdf))

Shumica e këtyre personave - 8.287 janë të punësuar me kohë të pacaktuar, 266 persona me kohë të caktuar dhe përmes APP-ve - 365 persona.<sup>16</sup>

Ministria e Financave vitin e kaluar [e publikoi](#) edhe numrin dhe rezultatet financiare të ndërmarrjeve publike dhe shoqërive aksionare, ku shihet se janë 14 NP të themeluara nga Qeveria, 15 shoqëri tregtare, nga të cilat 13 janë Sh.A. dhe 2 janë Sh.P.K.

Administrata më e vogël, por më efikase është pjesë e programit të Qeverisë nga viti 2017 e në vazhdim, por edhe e Qeverisë aktuale në programin e punës 2022-2024. Sipas këtyre angazhimeve, administrata duhet të reduktohet për rreth 20 për qind ose për rreth 26 mijë punonjës në sektorin publik.

Megjithatë, ka një dilemë lidhur me këtë çështje tek disa nga ekspertët në fokus grup. A i nënkupton Qeveria në këtë angazhim strategjik nëpunësit administrativë/shtetërorë që janë rreth 16 mijë apo të gjithë punonjësit në sektorin publik. Nëse i referohet të parës, sipas ekspertëve, numri optimal i punonjësve në administratën shtetërore me të cilin funksionon i gjithë aparati shtetëror do të ishte rreth 12 mijë punonjës, me atë që në disa institucione ka mbipunësim, kurse te disa ka mungesë njerëzish, edhe atë mjaft. Nëse, nga ana tjetër, nënkuptojmë një zvogëlim prej 20 për qind në të gjithë sektorin publik, që do të thotë rreth 26 mijë persona më pak, fillimisht duhet të bëjmë një vlerësim i detajuar i të gjithë sektorit publik dhe të shihet se ku, në cilët nënsektorë ka mbipunësim, e ku ka nën minimumin e nevojshëm. Si shembuj në bisedë janë përmendur zjarrfikësit, të cilët mungojnë në të gjithë vendin, mjekët dhe personeli mjekësor me përgatitje të mesme shkollore dhe arsimit. Për t'i vlerësuar të gjitha këto nevojiten detaje të sakta nga regjistrimi i popullsisë, në mënyrë që të planifikohen strategji dhe plane zhvillimore për pjesë të caktuara të sektorit publik, duke përfshirë edhe numrin e të punësuarve, thekson eksperti.

Konkluzioni i përgjithshëm do të ishte se ka një tepriçë të caktuar të punonjësve në sektorin publik, por për të krijuar një pasqyrë të plotë duhet të bëhen të gjitha analizat funksionale dhe të kryqëzohen me nevojat që do të dalin nga rezultatet e regjistrimit të popullsisë. Tek punonjësit në administratën shtetërore çështja e cilësisë është më e madhe se numri, megjithëse edhe atje mund të bëhet një racionalizim i kuadrit deri në 12 mijë nëpunës shtetërorë/administrativë, por duhet kushtuar kujdes cilësisë, e jo vetëm numrit.

## LLOGARIDHËNIA ME PROBLEME, TRANSPARENCA TRADICIONALISHT E MIRË

Një nga fushat për reformën e administratës publike është hapja dhe transparenca. Mund të thuhet se progresi në këtë fushë ka nisur menjëherë pas ndryshimit të qeverisë në qershor të vitit 2017, ndonëse progresi dukshëm është shënuar pas zbatimit të masave dhe aktiviteteve të planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë së Transparencës 2019-2021 dhe ri-miratimit dhe funksionimi në praktikë të Ligjit për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik, si dhe përmirësimi në drejtim të informimit proaktiv të publikut<sup>17</sup>.

Këtë e vërtetojnë edhe hulumtimet e realizuara nga "Metamorfozis" në kuadër të projektit rajonal në bashkëpunim me partnerët e rrjetit rajonal të OSHC-ve - Përgjegjësi, Teknologji dhe Rrjet i institucioneve të hapura në Evropën Juglindore (ACTION SEE). Matja e re e "Metamorfozis" tashmë ka përfunduar, por për shkak të kompleksitetit të verifikimit të të dhënave, ajo duhet të publikohet diku në qershor të vitit 2022.

Se gjërat po shkojnë mirë në këtë fushë reformuese mund të vihet re që në vitin 2021, së pari nga raporti gjashtëmuor për nivelin e përpjekjeve për reforma, ku thuhet se në atë periudhë janë regjistruar 53% aktivitete të realizuara, 13% janë në vazhdim dhe 34% kanë ngecje, por edhe nga raporti SIGMA (shih referencën 3), edhe pse në këtë raport vlerësimet janë më të rrepta për sa i përket llogaridhënies.

Në fakt, ka probleme me llogaridhënien që vërehen në raportet e SIGMA-s dhe të BE-së.

16 - "Vërtematës" - Numri i punonjësve në administratën shtetërore .... (në dispozicion në <https://vistinomer.mk/brojot-na-vrbotenit-vo-drzhavnata-administracija-opadnal-vo-javnite-ustanovi-se-zgolemit/>)

17 - IPE - korrik 2021 - Monitori Kombëtar ipër RAP, f.11 - (në dispozicion në <https://epi.org.mk/post/17312>)

## RIORGANIZIMI I ORGANEVE DHE INSTITUCIONEVE ENDE VETËM NË LETËR

Nevoja për riorganizim dhe transformim të institucioneve në administratën shtetërore dhe administratën publike është vënë re në raportet e fundit të BE-së, duke përfshirë këtu edhe atë të fundit, ku theksohet që në fjalinë e parë, në pjesën e llogaridhënies së administratës, se është e nevojshme të miratohet LOPASH-i i ri, i cili u ndryshua për herë të fundit në vitin 2019.

Në raportin e përmendur të SIGMA-s, nga ana tjetër, përmenden vërejtjet në lidhje me vendosjen e disa institucioneve dhe sugjerohet që Qeveria të pranojë riorganizimin e atyre institucioneve siç sugjerohet në konkluzionet e Projektit të zbatuar përmes IPA-s - "Mbështetje për Riorganizimin Shtetëror". Vërejtja kryesore është se ka organe dhe institucione, llogaridhënia e të cilave i drejtohet Kuvendit, mirëpo ato duhet t'u përgjigjen ministrive amë, d.m.th. atyre ministrive që i mbulojnë fushat e atyre organeve. Prandaj, sugjerohet që Qeveria dhe Kuvendi t'i identifikojnë këto organe shtetërore<sup>18</sup>.

Më shumë rreth kësaj kërkesë për riorganizim brenda institucioneve të administratës shtetërore mund të shihet nga Procesverbali i seancës së 9-të të Sekretariatit për Reforma në AP. Në atë takim të mbajtur në qershor të vitit 2021, eksperti i huaj që e menaxhon projektin IPA 2 "Mbështetje për Riorganizimin Shtetëror", në gjetjet dhe konkluzionet gjatë miratimit të propozimit të tyre për riorganizim, në mbledhje i prezantoi këto të dhëna:

"- nuk ekziston një sistem i vetëm hierarkik, shumë organe janë formuar me *lex specialis* (82), sesa sipas Ligjit për Organizimin e Punës së Organeve të Administratës Shtetërore (LOPASH) - 62 organe.

- ka 100+ përdorues buxhetorë të linjës së parë

- ka kritere të paqarta për statusin e personit juridik

- hierarkia e raportimit është konfuze, nuk dorëzohen raporte

- nuk ka përcaktim, ndarje të funksioneve: planifikimi i politikave, zbatimi, mbikëqyrja dhe kontrolli

Pikat kryesore të prezantimit ishin: më pak institucione përmes bashkimit dhe shpërbërjes së tyre, funksione ekzekutive brenda pushtetit ekzekutiv, hierarki e qartë në dorëzimin e raporteve në fushën e politikave, ndarje e funksioneve: forma, realizimi, kontrolli dhe lidhja me procesin e buxhetimit. Në prezantim, eksperti theksoi se cilat institucione do të bashkoheshin, cilat do të shpërbëheshin, si dhe cila drejtori do t'i nënshtrohej cilës ministri".

Nga Procesverbali i atij sesioni të 9-të të Sekretariatit mund të shihet se një nga organet kryesore nëpër të cilat do të shkojë riorganizimi, do të ishte krijimi i një agjencie digjitale, e më pas nën të të kalonin një sërë institucioneve të pavarura, si p.sh. Drejtoria për Udhëheqjen e Librave Amë, Regjistri Qendror, Agjencia e Kadastrës së Pasurive të Paluajtshme, MARNET-i dhe Regjistri Kombëtar për Reagimin ndaj Incidenteve Kompjuterike, Agjencia e Komunikimeve Elektronike etj. Diskutimi tregon se përfaqësuesit e MSHIA-së dhe Sekretariatit për Legjislacion, p.sh., kanë pyetje dhe paqartësi për riorganizimin e propozuar, por eksperti i huaj ka mbetur në dy qëndrime se një pjesë e mirë e riorganizimit të propozuar ka qenë nga vetë MSHIA-ja dhe se nëse Këshilli për Reforma, i kryesuar nga Kryeministri, ka ide të ndryshme për riorganizim, nuk do të ishte problem që eksperti të propozonte dhe të përshtatej me një plan të ri riorganizimi.

Ndryshe, kjo seancë e Sekretariatit për Reforma të AP-së është mbajtur menjëherë para seancës së fundit të Këshillit për Reforma, në të cilën këto çështje janë diskutuar në dy pjesë të seancës, në korrik të vitit 2021. Nuk ka asnjë komunikatë pas seancës së dytë, ndaj nuk dihet se cili është fati i këtij plani. Të rikujtojmë se pas seancës së parë, u komunikua se **në periudhën e ardhshme do të finalizohet Propozimi për strukturën e ardhshme organizative të organeve të administratës shtetërore, agjencive dhe shërbimeve inspektuese në nivel qendror dhe do të dorëzohet në seancë të Qeverisë.**"

18 - SIGMA - nëntor 2021 - Raporti i Monitorimit - fq.8 - (është në dispozicion në <https://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Republic-of-North-Macedonia.pdf>)

Megjithatë, duke pasur parasysh zgjedhjet lokale të tetorit të vitit 2021 dhe raportin e përmendur të SIGMA-s nga nëntori i vitit 2021, dorëheqjen e Qeverisë në dhjetor dhe formimin e një Qeverie të re, është e qartë se gjërat kanë ngecur, prandaj është edhe rekomandimi i planit SIGMA për të pranuar dhe për të bërë një riorganizim të tillë.

Edhe ekspertët dyshojnë se politika është pengesa kryesore në riorganizimin dhe miratimin e vetë LOPASH-it të ri.

- Edhe LOPASH-i i parë u miratua rreth njëzet vjet më parë me ndihmën e BE-së dhe ekspertëve të tyre. Meqenëse ky ligj votohet me dy të tretat e votave të deputetëve në Kuvend, nuk ka ndryshuar shpesh. Herën e fundit në vitin 2019, kur duhej të formohej Ministria e Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive, një ministri krejtësisht e panevojshme me 35 punonjës - nëpunës administrativë dhe nga e cila merrnin rroga mbi 2.000 punonjës jashtë të gjitha kritereve të sistemit të meritave, e në bazë të aplikimit të përfaqësimit të drejtë të pjesëtarëve të pakicave në vend, kryesisht të shqiptarëve, thotë eksperti. Disa nga këta persona më pas me programin K-5 u punësuan në rreth 1.300 institucione, por disa qindra që mbetën të pashpërndarë edhe më tej marrin rroga nga buxheti përmes kësaj ministrie.

Shembulli është dhënë nga eksperti si një nga çështjet për të cilat nuk ka pasur ndonjë problem të madh midis partive për të ndërhyrë në ndryshimin e LOPASH-it, por tani që realisht duhet ndryshuar për shkak të riorganizimit të gjerë, eksperti pret që kjo ndoshta të mos ndodhë, të paktën jo në të ardhmen e afërt dhe jo në mënyrë gjithëpërfshirëse. Ai shton se numri i tepërt i punonjësve aktual në institucionet që janë formuara jashtë LOPASH-it duke e anashkuar atë me ligje të veçanta (lex specialis), gjë që është e papranueshme, është bërë pikërisht si rezultat i marrëveshjeve ndërmjet koalicionëve për t'i dhënë "peshë" secilës palë se ajo menaxhon me institucionet ose i punëson anëtarët dhe mbështetësit e tyre.

- Që të funksionojë LOPASH-i, qindra punonjës do të duhet të humbasin vendin e punës, dhe më shumë institucione duhet të shpërbëhen ose të shkrihen në të tjera, por në nivel sektorësh, drejtorish, njësisht... Mu për shkak të marrëveshjeve mes koalicionit dhe "paqes në shtëpi", kjo pjesë e reformës është shumë e vështirë - përfundon eksperti.

Por, një ekspert tjetër nga fokus grupi pohon kategorikisht se nuk varet gjithçka vetëm nga vullneti politik. Sipas saj, bëhet fjalë për propozime problematike se si të bëhet ai riorganizim, të cilat ndikojnë në politikat strategjike në disa ministri, dhe si shembull u përmend Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe zbatimi i politikave për të drejtat e grave dhe politikat gjinore.

Ajo që është një vlerësim i pandarë i ekspertëve nga fokus grupi është se është e pakuptueshme pse i gjithë procesi është i mbyllur dhe jo transparent. Vetëm një pjesë e OSHC-ve kishin njohuri për planin e propozuar nga ekipi i ekspertëve të projektit, dhe takimi dhe kontakti i fundit lidhur me këtë projekt ishte diku në shtator të vitit të kaluar, por as atëherë nuk u ndanë detaje. Ajo që mund të kuptohet nga ekspertët është se BE-ja që e mbështet projektin përmes programit IPA 2, nga kohëzgjatja fillestare prej 2 vitesh, në vitin 2021 e ka zgatur kohëzgjatjen dhe mbështetjen financiare të këtij projekti edhe për vitin 2022.

Hetimi se ku kanë ngecur gjërat u zbardh me dy të dhëna. Qeveria e ka shqyrtuar tashmë statusin e këtij projekti në seancën e 23-të, në mars të vitit 2022, si pikë e 139 e rendit të ditës me titull: Informacion mbi statusin e realizimit të aktiviteteve në kuadër të projektit IPA 2017 "Mbështetje për Riorganizimin Shtetëror"<sup>19</sup>. Në konferencën e fundit për shtyp të MSHIA-së, ministri kompetent ka bërë të ditur se në atë kohë është marrë vendim me të cilin obligohen tri ministri, MSHIA-ja, Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Ekonomizim me Ujërat, që të fillojnë përgatitjet për zbatimin e organizimit të ri si pilot ministri, pasi të miratohet ligji.<sup>20</sup>

19 - Qeveria e RMV-së - Rendi i ditës së seancave të Qeverisë së RMV-së - (në dispozicion në <https://vlada.mk/2022-23>)

20 - MSHIA - 31.3.2022 - Admirim Aliti / konferencë për shtyp - (në dispozicion në <https://www.mioa.gov.mk/?q=mk/node/3947>)



## TRANSPARENCA DHE HAPJA PËRPAROJNË MIRË

Fusha më e mirë është sigurisht transparenca dhe hapja. Këtu meritë kanë vullneti politik, Strategjia e Transparencës 2019-2021, [Strategjia e të Dhënave të Hapura](#) dhe zgjidhjet ligjore. Një rol kyç ka edhe vendosmëria, përkatësisht vullneti politik. Qeveria që nga viti 2017, kur në pushtet erdhi grupi aktual politik, me vetë emërimin e [ministrit pa portofol, përgjegjës për komunikim, transparencë dhe llogaridhënie](#), si dhe me miratimin e një strategjie të komunikimit, tregoi vullnet politik për hapje të institucioneve në komunikim me publikun dhe qytetarët. Më pas, si rrjedhojë e kësaj dhe e ligjit dhe Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin e Qeverisë së Hapur, pasuan fillimisht 21, e tani 22 dokumente të detyrueshme, të cilat çdo institucion i pushtetit qendror apo organ i administratës duhet t'i ketë publikuar në faqet e tij të internetit. Rezultat i vullnetit politik ishte edhe ndryshimi i Ligjit për Qasje në Informatat me Karakter Publik, përbërja e re dhe transformimi i ish-Komisionit në [Agjencinë për Mbrojtjen e të Drejtës për Informata me Karakter Publik](#), dhe të gjitha së bashku çuan në rezultate më të mira se në periudhën e mëparshme. Përveç kësaj, Agjencia ka staf solid dhe një ueb-faqe të mirë, dhe që nga mesi i vitit 2021 ka miratuar edhe [Planin Strategjik](#), i cili "i përcakton parimet, qëllimet strategjike dhe vlerat përmes të cilave Agjencia do të sigurojë qasje të barabartë dhe të lirë në informatat me karakter publik".

Se gjërat po shkojnë mirë në këtë drejtim, për sa i përket hapjes së institucioneve, tregojnë më së miri edhe numrat e fundit të marra përmes një projekti rajonal të realizuar nga "Metamorfozis" në bashkëpunim me partnerët e rrjetit rajonal të OSHC-ve "Përgjegjësi, Teknologji dhe Rrjet i Institucioneve të Hapura në Evropën Juglindore" (ACTION SEE). Sipas rezultateve të fundit të matjes për transparencë, më e hapur është Qeveria e Maqedonisë së Veriut, e cila plotëson 83,43% të kriterëve të përcaktuara për hapje, ministritë në Qeveri kanë indeks prej 62%, organet e administratës 45,5% dhe Kuvendi i RMV-së me një indeks prej 68 për qind<sup>21</sup>.

Në periudhën e përfundimit të këtij raporti, në mars të vitit 2022, në rrjedhë e sipër është sistematizimi dhe matja e të dhënave të reja për transparencën e institucioneve në kuadër të projektit të drejtuar nga "Metamorfozis", gjatë së cilës do të mund të bëhet edhe rivlerësimi i vendit, por dhe krahasimi në nivel rajonal.

Me hyrjen në fuqi të Strategjisë, si rezultat i drejtpërdrejtë është Portali i të Dhënave të Hapura. Portali u promovua në vitin 2018 dhe atëherë në të kishte 111 grupe të dhënash.<sup>22</sup> Nëse shkoni në adresën elektronike të faqes - <http://www.data.gov.mk> - në seksionin [Statistika](#), mund të vërehet se në të (**më 14 mars 2022 kur u mor ky shembull**), ka 637 grupe të dhënash nga institucionet dhe organet e pushtetit qendror dhe lokal. Numri është ende i vogël, por deri në vitin 2021 ka pasur një mospërputhje mes institucioneve të pushtetit qendror dhe atij lokal. Gjegjesisht, deri në vitin 2021, vetëm disa dhjetëra grupe të dhënash të hapura ishin nga vetëqeverisja lokale, ku kryesonte Qyteti i Shkupit, me gjithsej 17 grupe të dhënash. Është vërejtur se disa nga komunat më të vogla nuk kishin asnjë, dhe komuna e Vallandovës ishte në krye me 11 grupe të dhënash. Mirëpo, gjatë gjysmës së dytë të shkurtit dhe në muajin mars, vërehet një ndryshim drastik në publikimin e grupeve të të dhënave nga vetëqeverisja lokale, që më së shumti vjen si pasojë e bashkëpunimit të vetëqeverisjes lokale me Fondacionin Metamorfozis në kuadër të Projekti për Pjesëmarrje Qytetare, i mbështetur nga USAID-i, përmes të cilit bëhet trajnimi i administratorëve dhe punonjësve në vetëqeverisjen lokale<sup>23</sup>. Ky rezultat më i mirë me të dhënat e hapura është arritur vetëm me pjesëmarrjen e gjysmës së vetëqeverisjes lokale, sepse përmes këtij projekti marrin pjesë 44 komuna në RMV, ndërsa të tjerat nuk iu përgjigjën pozitivisht ftesës për një bashkëpunim të tillë.

Përveç kësaj, ueb-faqja e qeverisë është e mbushur vazhdimisht me të dhëna rreth [çdo seance të Qeverisë](#) apo aktiviteti të ministrave dhe organeve të Qeverisë së RMV-së, si dhe vazhdoi praktika e publikimit të pikave të rendit të ditës dhe procesverbaleve nga seancat e Qeverisë. Fatkeqësisht, ende nuk janë publikuar shënimet e stenografëve nga debati, as materialet e dorëzuara në seancën e Qeverisë, bile edhe kur bëhet fjalë për dokumente të hapura, si informacione, analiza, propozim-ligje etj., megjithëse në diskutime me mediat dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, përfaqësuesit e departamentit për komunikim

21 - "Metamorfozis" - 28.9.2021 - Konferenca: transparenca e pushtetit ekzekutiv... - (në dispozicion në [https://metamorphosis.org.mk/aktivnosti\\_arhiva/konferencija-transparentnost-na-izvrshnata-vlast-korsokak-za-informacite/](https://metamorphosis.org.mk/aktivnosti_arhiva/konferencija-transparentnost-na-izvrshnata-vlast-korsokak-za-informacite/))

22 - Qeveria e RMV - 24.12.2018 - Promovohet portali për Të dhënat e hapura - (në dispozicion në <https://vlada.mk/node/16216>)

23 - Fondacioni @Metamorfozis@ - 18.1.2022 - U zhvillua trajnimi online për transparencë dhe të dhënat e hapura ...- (në dispozicion në [https://metamorphosis.org.mk/aktivnosti\\_arhiva/sprovedena-onlajn-obuka-za-transparentnost-i-otvoreni-podatoci-na-edinicite-na-lokalnata-samouprava/](https://metamorphosis.org.mk/aktivnosti_arhiva/sprovedena-onlajn-obuka-za-transparentnost-i-otvoreni-podatoci-na-edinicite-na-lokalnata-samouprava/))

të Qeverisë, shpesh thoshin se ky nuk ishte problem. Nga mjetet e tjera me të cilat matet transparencja, vlen të përmendet [Mjeti për llogaridhënien e bartësve të funksioneve publike](#), përmes të cilit çdo institucion dorëzon disa herë në vit të dhëna se për çfarë shpenzohen paratë nga buxheti i institucionit përkatës. Këtu të dhënat publikohen edhe në format të hapur, edhe pse shpejtësia me të cilën është bërë kjo është e diskutueshme dhe të dhënat vonohen me muaj. Kjo në një farë mënyre e zhvlerëson arsyen pse u hap ajo faqe interneti. Por, sigurisht, edhe këto të dhëna kontribuojnë për transparencën.

Megjithatë, vlerësimi i zbatimit të Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë së Transparencës 2019-2021, në fushën e transparencës, i zbatuar nga Fondacioni "Metamorfozis", tregon se ka ende shumë punë për të bërë në këtë fushë. Në vlerësimin e fundit, i cili u kompletua dhe u publikua së fundmi, thuhet si më poshtë:

**Nga gjithsej 45 aktivitete në Planin e Veprimit, nëntë janë përfunduar plotësisht brenda afatit të paraparë, tre janë përfunduar me vonesë, ndërsa tetë aktivitete janë ende në vazhdim, përkatësisht në realizimin e sipër. Të përcaktuara janë gjithsej 25 aktivitete<sup>24</sup>.**

Të dhënat nga një tjetër matje e bërë nga Fondacioni "Metamorfozis", matja e indeksit të hapjes së njësive të vetëqeverisjes lokale, flasin për gjendjen e luhatshme me transparencën. Nga këto të dhëna për vitin 2021, vihet re se hapja e matur sipas më shumë se 100 treguesve, vitin e kaluar ishte më e ulët se [të dhënat e vitit 2018](#), për shembull. Sipas matjes nga viti 2021, me një metodologji të re, edhe më të detajuar, transparencja më e lartë kumulative e një komune është 56 për qind (Ohri), ndërsa hapja totale më e ulët është 3 për qind (Pllasnica)<sup>25</sup>.

## TRANSPARENCA FINANCIARE - PAGESAT DITORE NGA THESARI

Ndër arritjet me të cilat Qeveria mund të krenohet është transparencja financiare. Për dallim nga shumë qeveri të tjera në rajon, Qeveria e RMV-së ishte e para që e vendosi transparencën financiare, në kuptim të shpenzimit të parave nga buxheti i qeverisë qendrore, dhe në periudhën e kaluar mund të ndiqen edhe nga pagesat nga një pjesë e pushtetit lokal për përdorues të ndryshëm buxhetorë, persona juridikë dhe fizikë.

Të dhënat janë publikuar në portalin "Financat e Hapura" (<https://open.finance.gov.mk/mk/home>), me ç'rast mund të gjenden më shumë se 22,5 milionë transaksione. Në portal mund të shihen kategoritë për "Realizimin e buxhetit sipas muajve", për "Përfituesin më të madh" të parave buxhetore sipas muajve, "Dhënësin më të madh", për "Borxhin publik" duke e përfshirë borxhin shtetëror, borxhin e komunave dhe borxhin e ndërmarrjeve publike dhe pagesat për mbi 1.100 institucione, mbi 70.000 kompani dhe mbi 1.3 milion individë.

Ajo që vlen të përmendet janë dy gjëra - të dhënat përditësohen në baza ditore, si dhe fakti se në arkiv mund të gjenden të gjitha të dhënat për pagesat nga viti 2010 e deri më tani.

Komunat nuk mund të mburren me një transparencë të tillë financiare, d.m.th. pushteti lokal dhe shumë prej ndërmarrjeve publike në nivel qendror apo lokal. Në fakt, kur bëhet fjalë për transparencën financiare, ndiqet trendi i transparencës së përgjithshme - ajo është në rënie si horizontalisht ashtu edhe vertikalisht duke u nisur nga pushteti qendror e teposhtë, dhe mu për këtë arsye vlera e sistemit të Financave të Hapura është edhe më e madhe.

24 - Fondacioni "Metamorfozis" - 2.2022 - Vlerësim i nivelit të zbatimit të Planit Aksional të Strategjisë për Transparencë (2019-2021) në periudhën nëntor 2019 - nëntor 2021 në dispozicion në [https://metamorphosis.org.mk/aktivnosti\\_arhiva/procenka-na-nivoto-na-sproveduvanje-na-akciskiot-plan-na-strategijata-za-transparent-nost-2019-2021-vo-periodot-noemvri-2019-noemvri-2021/](https://metamorphosis.org.mk/aktivnosti_arhiva/procenka-na-nivoto-na-sproveduvanje-na-akciskiot-plan-na-strategijata-za-transparent-nost-2019-2021-vo-periodot-noemvri-2019-noemvri-2021/)

25 - Fondacioni "Metamorfozis" - 2021 - Indeksi i Hapjes së Vetëqeverisjes lokale 2021 - (në dispozicion në [https://metamorphosis.org.mk/izdaniya\\_arhiva/indeks-na-otvorenost-na-lokalnata-samouprava-2021/](https://metamorphosis.org.mk/izdaniya_arhiva/indeks-na-otvorenost-na-lokalnata-samouprava-2021/))

## SHËRBIMET E ADMINISTRATËS - SHUMË HAPËSIRË PËR PËRMIRËSIM

Një nga elementët e një administrate të mirë, të reformuar të pranuar nga OBEZH-it dhe BE-ja është çështja e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe personave juridikë, biznesit, d.m.th. ndërtimi i një administrate që synon nevojat e qytetarëve, e cila do të ofrojë shërbime lehtësisht të qasshme<sup>26</sup>.

Sipas shumicës së analizave dhe raporteve që kanë të bëjnë me këtë fushë që nga reformimi i administratës, gjërat janë shumë më ndryshe se në vitin 2017 dhe është bërë progres. Por, ky progres lidhet më shumë me ligjet kyçe që janë të nevojshme për ofrimin e shërbimeve, por jo edhe në shumicën e fushave të shërbimeve të ofruara nga administrata. Në vitin 2019, nga Kuvendi i RMV-së u miratuan dispozitat kryesore ligjore - Ligji për Regjistrin Qendror të Popullsisë, Ligji për Menaxhimin Elektronik dhe Shërbimet Elektronike dhe Ligji për Dokumentet Elektronike, Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet Konfidenciale. Por, për ta zbatuar vertikalisht në mënyrë më efektive, që shpesh nënkupton edhe shërbime digjitale të ofruara nga administrata, qindra ligje duhet të sinkronizohen dhe të ndryshohen. Qeveria ka arritur në një konkluzion të tillë për harmonizimin e 150 ligjeve në fusha të ndryshme në mars të vitit 2021<sup>27</sup> dhe për këtë është duke punuar një grup i posaçëm pune i koordinuar nga Kryeministri, ndërsa në forume të ndryshme ku diskutohet kjo çështje, për shembull reformat në drejtësi, është përmendur edhe numri prej mbi 200 ligje<sup>28</sup>.

Hulumtimi ynë tregon se në korrik dhe gusht të vitit 2021, Qeveria ka debatuar për këtë çështje. Fillimisht, kryeministri dhe zëvendëskryeministri morën pjesë në një takim me grupin punues për përgatitjen e ndryshimeve dhe plotësimeve të ligjeve për digjitalizimin e proceseve, duke e nënvizuar vendosmërinë e Qeverisë për ta shtyrë këtë proces si prioritet me synimin përfundimtar të administratës moderne digjitale, e cila do të ofrojë shërbime të tilla për qytetarët dhe biznesin<sup>29</sup>, e disa javë më vonë në një seancë të Qeverisë, sipas informacionit të zëvendëskryeministrit, është konstatuar që deri në fund të gushtit të gjitha ligjet e nevojshme për procesin e digjitalizimit duhet të ndryshohen dhe harmonizohen dhe të dorëzohen në Kuvend<sup>30</sup>.

Se sa nga kjo është arritur mbetet e paqartë, duke qenë se ka pasur pasivitet për shkak të fushatave zgjedhore për zhvillimin e zgjedhjeve lokale, më pas bisedat për një shumicë të re qeveritare, më pas një qeveri e re, e kështu me radhë. Megjithatë, është fakt që administrata moderne dhe shërbimet e digjitalizuara që synojnë qytetarin janë pjesë e Programit të Qeverisë së re<sup>31</sup> për periudhën 2022-2024, dhe ajo është ende prioritet i Qeverisë i përfshirë në listën e prioriteteve të përgjithshme strategjike të barabarta për nga rëndësia, si dhe prioritet strategjik për vitin 2022<sup>32</sup>. Megjithatë, se po punohet në harmonizimin e ligjeve, tregojnë disa ndryshime të tilla që janë propozuar dhe miratuar nga Kuvendi deri në fund të vitit të kaluar në fushën e punës dhe mbrojtjes sociale, dhe një hap i madh ligjor do të bëhet me miratimin e ndryshimeve në Ligjin për Evidencën Amë, i cili nga nëntori i vitit 2021 është vendosur në ENER për debat publik dhe ndryshimet e të cilit janë pikërisht nga aspekti i evidencës elektronike dhe identifikimit elektronik, për procedurat që kanë të bëjnë me evidencën amë të qytetarëve. Konfirmim ka edhe nga një nga ekspertët e fokus grupit, i cili ka përmendur disa ligje që janë ndryshuar pikërisht në drejtim të digjitalizimit të shërbimeve, duke përmendur Ligjin për të Drejtat Sociale, Ligjin për të Drejtat e Fëmijëve, Ligjin për Mbrojtjen Shëndetësore në fushën e dhënies me koncesion për kujdesin parësor shëndetësor, ligjet për arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë, aktet nënligjore për dhënien e bursave etj.

26 - SIGMA/OBEZH/BE - Parimet e Administratës Publike - 2017 - fq. 65 (në dispozicion në <https://www.sigmaweb.org/publications/Principles-of-Public-Administration-2017-edition-ENG.pdf>)

27 - SIGMA - nëntor 2021 - - Raporti i Monitorimit - fq.109 - (është në dispozicion në <http://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Republic-of-North-Macedonia.pdf>)

28 - Burimi është një nga ekspertët e "Metamorfozës" të konsultuar në kuadër të projektit, i cili merr pjesë në një grup pune për të ndryshuar disa nga ligjet në gjyqësor.

29 - Qeveria e RMV - 28.06.2021 - Komunikatë - (në dispozicion në <https://vlada.mk/node/25736>)

30 - Qeveria e RMV - 13.07.2021 - Komunikatë - (në dispozicion në <https://vlada.mk/node/25913>)

31 - Programi për punë i Qeverisë së RMV-së 2022-2024 - fq.26 (në dispozicion në [https://vlada.mk/sites/default/files/programa/2022-2024/programa\\_na\\_vladata\\_2022-2024.pdf](https://vlada.mk/sites/default/files/programa/2022-2024/programa_na_vladata_2022-2024.pdf))

32 - "Gazeta zyrtare" e RMV-së nr.97 nga 29.04.2021 - (në dispozicion në [https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/odluka\\_za\\_utvrduvanje\\_na\\_strateshkite\\_prioriteti\\_na\\_vladata\\_2022\\_sl\\_vesnik\\_na\\_rsm\\_br\\_97\\_od\\_29.4.2021.pdf](https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/odluka_za_utvrduvanje_na_strateshkite_prioriteti_na_vladata_2022_sl_vesnik_na_rsm_br_97_od_29.4.2021.pdf))

Por, vitin e kaluar, sektori i shoqërisë civile analizoi legjislacionin që është vendimtar për digjitalizimin e shërbimeve dhe konstatoi mospërputhje në disa nga ligjet bazë, si dhe mungesën e ndryshimeve ligjore në disa ligje kyçe të institucioneve që duhet të ofrojnë shërbime, si p.sh. si ligjet për dokumentet personale dhe të udhëtimit. Në analizën e përgatitur nga Instituti i Shkencave Sociale dhe Humane nga Shkupi, është bërë një rishikim mjaft kritik pas shqyrtimit të tri ligjeve bazë (ato të vitit 2019), të cilat janë të rëndësishme për digjitalizimin e shërbimeve dhe përputhshmërinë e tyre me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative:

**"Përpyekja për futjen e digjitalizimit në udhëheqjen e librave amë para miratimit të ligjeve për digjitalizimin nga viti 2019 është për t'u përshëndetur. Realizimi, nga ana tjetër, është objekt i analizës kritike, e cila tregon një preferencë për inercinë nga epoka paradigjiale, filozofia e administrimit e trashëguar nga epoka e të ashtuquajturit shtet i robëruar (i tjetërsuar nga "njeriu i vogël"), gjegjësisht inercia e aparatit publik autoritar dhe joefikas. Do t'i lejojmë vetes të ndajmë përshtypjen se në mënyrën se si përfytyrohen veprimet, kontradiktat e tyre dhe fakti që zgjidhja e kontradiktave i është lënë qytetarit të thjeshtë në vend të aparatit administrativ, shohim një lloj sadizmi të shtetit të fuqishëm kundrejt "qytetarit të gjoja të korruptuar". Vërehet qasja e ligjvënësit sipas së cilës edhe një lapsus i thjeshtë dhe lëshim teknik trajtohet si gjest kriminal në vend se rezultat i mosdijes, lapsus callami, të cilin shteti, nëse vendoset sipas parimeve të EPTP-së, duhet ta zgjidhë me vullnet të mirë dhe proaktivitet "- thuhet në hyrje të analizës<sup>33</sup>.**

Gjithashtu, jepen edhe rekomandime se si duhet të jenë ndryshimet në ligjet për dokumentet personale dhe ato të udhëtimit:

**"Ligjet e posaçme për dokumentet personale, duke edhe përfshirë certifikatat, duhet t'i nënshtrohen sa më shumë që të jetë e mundur tre ligjeve për administratën e digjitalizuar, kurse në frymën e procedurës efikase dhe të lirë, që është parim themelor i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA), si dhe i Kartës Evropiane e të Drejtave Themelore në seksionin që e shpjegon të drejtën për administratë të mirë. Vërejtje të ngjashme kemi edhe për ligjet e tjera për dokumentet personale të përpunuara në këtë studim, si dhe për dokumentet shoqëruese strategjike për digjitalizimin, të cilat do t'i përmbledhim në konkluzione dhe rekomandime".**

Njëri nga ekspertët e fokus grupit vlerësoi se tre ligjet kryesore janë përgjithësisht të mira dhe se duhet të bëhen vetëm rregullime të imëta në disa pjesë të ligjeve, duke vënë theksin tek Ligji për Dokumentet Elektronike, Identifikimi Elektronik dhe Shërbimet Konfidenciale.

Edhe raporti i SIGMA i nëntorit të vitit 2021 vë në dukje situatën e ndryshme nga viti 2017, se në raport me vendet e Ballkanit Perëndimor kjo situatë është pak mbi mesataren në RMV, por që në ndryshimet në praktikë, pra në zbatim, ka rezultate të ndryshme:

"Përmirësimi i politikave në këtë fushë shoqërohet me rezultate të përziera për sa i përket zbatimit të saj. Ka pasur zhvillime të rëndësishme që kanë pasur një ndikim të madh në ofrimin e shërbimeve publike, siç është krijimi i Regjistrimit Qendror të Popullsisë, Platforma e Ndërveprueshmërisë dhe Portali Kombëtar i Shërbimeve Elektronike. Megjithatë, nga analiza e një kampioni të shërbimeve rezultojnë se raportimi dhe pagesa e tatimit mbi të ardhurat personale është përmirësuar dukshëm me futjen e sistemit të ri elektronik të tatimit personal në vitin 2018, duke i përfshirë edhe fletëparaqitjet tatimore të plotësuara më parë të përgatitura nga DAP-i për të gjithë tatimpaguesit. Në rastin e shërbimeve të tjera nuk ka zhvillim më të madh që nga viti 2017. Për shembull, për rinovimin e dokumentit për identifikimit personal, nuk ka mundësi të dorëzohet një formular elektronik" - thuhet në raportin e monitorimit të nëntorit 2021.

## **SHËRBIMET ELEKTRONIKE DIGJITALE, GJENDJA AKTUALE**

Se procesi megjithatë është në lëvizje mund të konkludohet nga seria e takimeve që gjatë gjysmës së dytë të janarit dhe shkurtit të vitit 2022 i ka pasur ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës me një sërë subjektësh, siç është edhe takimi i mbajtur më 7 shkurt me Drejtorin e Drejtorisë për Udhëheqjen e Librave Amë (DULA), ku tema ishin "digjitalizimi i shërbimeve dhe përmirësimi i proceseve". Të dy bashkëbiseduesit përfunduan "se duhet të formohen grupe pune që do ta analizojnë situatën aktuale dhe të ndërmerren veprime të mëtejshme për arritjen e qëllimeve"<sup>34</sup>.

33 - IOHNS - Digjitalizimi si një rrugë e administratës së vërtetë të orientuar nga qytetari: Decentralizimi i proceseve si një mjet i reformave të përshpejtuara dhe efektive - 2021 - fq. 7 - (në dispozicion në <https://bit.ly/3oSwU85>)

34 MSHIA - 7.2.2022 - Komunikatë - (në dispozicion në <https://www.mioa.gov.mk/?q=mk/node/3807>)

Sa i përket gjendjes aktuale me shërbimet që i ofron DULA, nuk ka dyshim se duhet të diskutohet, theksuan ekspertët. Sipas tyre, disa nga ato shërbime që duhet të funksionojnë në mënyrë elektronike, funksionojnë me cilësi më të ulët se dy vite më parë, për shembull, kurse arsyeja për këtë nuk dihet saktësisht. Mirëpo, Zëvendës Avokati i Popullit, i cili konfirmoi se kanë shumë ankesa për shërbimet e DULA-s, së fundi e përshkroi saktësisht arsyen e mundshme për DULA-n dhe në përgjithësi për institucionet e tjera shtetërore:

**"Kam një kohë të gjatë që punoj te AP-ja dhe mund të them se jam ndër themeluesit e këtij institucioni dhe për fat të keq mund të them që edhe pas 25 vitesh të AP-së, institucionet shtetërore nuk kanë kulturë të respektimit të të drejtave të njeriut. Ata nuk janë të vetëdijshëm se duhet të jenë shërbim për qytetarët, e jo pronarë të të drejtave të tyre.<sup>35</sup>**

Në raportin e fundit të BE-së për vitin 2021 në fushën e shërbimeve të administratës thuhet se e-portali kombëtar po përmirësohet, gjë që është inkurajuese, por edhe se institucionet shtetërore "duhet të tregojnë angazhim më të madh për ofrimin e shërbimeve përmes e-portalit kombëtar". Në të njëjtën kohë, theksohet se në shumë fusha nuk ka përparim:

"Përdorimi i nënshkrimeve elektronike për shërbime për qytetarët dhe kompanitë është rritur në mënyrë modeste. Korniza e ndërveprueshmërisë është rritur për nga vëllimi, por nevojitet vullnet politik dhe financim për të arritur potencialin e tij të plotë. "Shumë shërbime kyçe bazë, si dhënia e pasaportave, patentë shoferëve, dëfetsave të shkollës, regjistrimi i automjeteve, janë vonuar ndjeshëm dhe kanë shkaktuar pakënaqësi te qytetarët"<sup>36</sup>.

Sipas ekspertëve të fokus grupit, mund të dallohen tre lloje problemesh. E para është nënshkrimi elektronik, i cili tani është i shtrenjtë madje edhe për personat juridikë (përmes KIBS-it ai kushton 3.500 denarë). Problemi i dytë është ndryshimi i ligjeve dhe ngadalësia e atij procesi, i cili shpeshherë varet edhe nga Kuvendi i RMV-së. E treta është ngurtësia e vetë administratës dhe interpretimi i dyfishtë i ligjeve, andaj, edhe pse sipas ligjeve kryesore për digjitalizimin, ato të vitit 2019, e poashtu edhe sipas LPPA-së, dokumenti elektronik duhet të jetë i vlefshëm, ai njihet vetëm diku, e diku kërkohen procedura fizike shtesë në sportele apo nëpër arkiva. Sipas një eksperti tjetër, edhe tani nënshkrimi elektronik i lëshuar nga KIBS-i nuk është shumë i shtrenjtë për individët, por gjithsesi i gjithë procesi duhet të udhëhiqet nga Regjistri i Vetëm Kombëtar i Popullsisë. Supozimi i ekspertit është se nuk ka kapacitet për këtë, kështu që ky proces i është besuar BPRM-së.

Sa i përket nënshkrimit elektronik, MSHIA-ja po zhvillon bisedime me kompaninë MASTERCARD, duke kërkuar një zgjidhje më të thjeshtë dhe më të shpejtë të këtij problemi, duke përmendur jozyrtarisht edhe dhënien apo sponsorizimin e mijëra nënshkrimeve elektronike për personat fizikë për përshpejtimin e procesit.

Edhe pse ky proces i shërbimeve elektronike ka nisur vite më parë, progresi është modest, deri në i moderuar. Në fillim të vitit të kaluar ishin rreth 150 shërbime elektronike të ofruara plotësisht, ndërsa në momentin e hartimit të këtij raporti ka 184 shërbime të tilla nga mbi 1.300 sipas katalogut dhe mbi 800 që janë përcaktuar nga shteti për t'u vendosur në portalin qeveritar. Shembuj të mirë janë ehe shërbimet digjitale që ofron gjyqësori, të cilat aktualisht janë ndër më të kërkuarat - vërtetimet e mosdënimit apo vërtetimet se nuk ka ndalim administrativ nga gjykata për të kryer ndonjë veprimtari. Pak ditë para fundit të marsit të vitit 2022, zëvendësministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Aleksandar Bajdevski, tha se për këtë vit janë planifikuar rreth 40 shërbime të reja:

"Aktualisht 43 shërbime janë në zhvillim e sipër dhe pritet të publikohen në portal në periudhën qershor-shtator 2022. Në kuadër të këtij projekti është duke u zhvilluar edhe Regjistri i regjistrave, në të cilin do të ruhen të dhënat për regjistrat e të gjitha institucioneve shtetërore, pavarësisht nëse janë të digjitalizuar. Gjithashtu janë prokuruar pajisje për 11 klientë komunikimi, me të cilët do të lidhen 11 institucione të reja në platformën e ndërveprueshmërisë.<sup>37</sup>

35 - Suzana Saliu - TV "Telma" / Programi i mëngjesit - 9.3.2022

36 - KE - Raporti për Maqedoninë e Veriut për vitin 2021 - tetor 2021 - fq. 20 - (në dispozicion në <https://www.sep.gov.mk/data/file/Pregovori/North-Macedonia-Report-2021-%D0%9C%D0%9A2.pdf>)

37 - MSHIA - 23.3.2022 - Komunikatë/Bajdevski - (në dispozicion në <https://www.mioa.gov.mk/?q=mk/node/3926>)

## SHËRBIMET DIGJITALE TË VETËQEVERISJES LOKALE

Si proces që duhet të zhvillohet së shpejti është rritja e vëllimit të shërbimeve digjitale të ofruara nga komunat, d.m.th. Nga vetëqeverisja lokale. Tani për tani kjo po ndodh në mënyrë josistematike, në disa komuna si pilot-projekt i mbështetur nga fondet ndërkombëtare kurse vetë komunat po përfshihen shumë ngadalë. Përmes Shoqatës së Vetëqeverisjes Lokale - BNJVL ofron një pjesë shumë të vogël të shërbimeve, për shembull, dhënien e lejeve për ndërtim. Në disa komuna problem janë edhe kuadri dhe financat. Por në komunat e tjera, si në qytetin e Shkupit, ku pushteti lokal ka një buxhet prej qindra milionë eurosh, ka thjesht ngurrim.

Disa ekspertë mendojnë se nuk bëhet fjalë gjithmonë për probleme personeli apo financiare, por për ngurrim për arsye të shumta, kurse njëra prej tyre mund të jetë e natyrës korruptive, d.m.th. mosgatishmëria për të hequr dorë nga pushteti për zgjidhjen arbitrare të shërbimeve qytetare “në sportel”.

Tashmë është përmendur ndihma e organizatave joqeveritare, si ajo e Fondacionit "Metamorfozis", i cili punon me vetëqeverisjen lokale për digjitalizimin e të dhënave me të cilat disponojnë komunat, e të cilat duhet të shndërrohen në grupe të dhënash digjitale dhe të vendosen në portalin Të Dhënat e Hapura, por edhe për të avancuar digjitalizimin e plotë të administratës komunale që në fund të fundit duhet të rezultojë me sa më shumë shërbime elektronike.

Përshpejtimi i procesit të e-shërbimeve të komunave, sipas ekspertëve, mund të ndodhë edhe nëse përdoret portali qendror E-shërbimet, për të cilin ka mundësi teknike, pra nuk ka ndonjë pengesë të veçantë dhe nuk duhet të pritet digjitalizimi i plotë i administratës së vetë komunave dhe modernizimi i portaleve të tyre.

## DIGJITALIZIMI I TË GJITHË ADMINISTRATËS DHE FINANCAVE/BUXHETIT PËR REFORMA

Digjitalizimi i administratës dhe zhvillimi i shërbimeve digjitale nuk mund të ndahen. Këto janë procese komplementare dhe, sipas ekspertëve, nuk qëndrojmë aq keq, por sigurisht që ka vend për zbatim shumë më të shpejtë. Një shembull i mirë është sigurisht nënshkrimi i paradokohshëm i marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe 34 institucioneve të tjera për shkëmbim të shpejtë dhe elektronik të të dhënave ndërmjet gjyqësorit dhe institucioneve që u promovua publikisht në Qeverinë e RMV-së. De fakto, RMV-ja është bërë praktikisht vendi i parë në rajon ku 34 gjykata në vend i shkëmbejnë të dhënat në mënyrë elektronike dhe që nga momenti i nënshkrimit, 9 institucione mund të shkëmbejnë drejtpërdrejt të dhëna me gjyqësorin. Përmes platformës së ndërveprimit, gjykatat tashmë janë të lidhura me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Prokurorinë Publike, Drejtorinë Doganore, Regjistrin Qendror, KSHZ-në, Drejtorinë e Policisë Financiare, Drejtorinë e Inteligjencës Financiare, KSHPK-në dhe MNAV-in - Agjencinë e Aviacionit Civil<sup>38</sup>. 39 institucione janë të lidhura me Platformën e Ndërveprueshmërisë që nga data 29 nëntor 2022, me tendencë që së shpejti, deri në fund të marsit, të bashkohen edhe 15 institucioneve të tjera.

Qëllimi i raportit ishte të zbulohet nëse kjo pjesë e reformave financohet në përputhje me nevojat dhe detyrat e Planit të Veprimit. Ajo që dihet gjerësisht në opinion është se MSHIA-ja për këtë vit ka ndarë 4 milionë euro vetëm për digjitalizim, plus Ministria e Drejtësisë 1.5 milionë euro për proceset e digjitalizimit në gjyqësor. Supozohet se edhe ministri dhe institucione të tjera në buxhetet e vitit 2022 kanë parashikuar mjete të tilla. Por, sa janë ato shuma dhe a mjaftojnë? Kjo përgjigje nuk mund të merret, nëse buxhetet nuk kërkohen manualisht nga institucioni në institucion, e ndonjëherë as në atë mënyrë, sepse në vend buxheti ende nuk bëhet në bazë të programeve. Njëri nga ekspertët tha se është duke u përgatitur një ligj i ri për buxhetin, i cili do të ketë buxhetim sipas programeve, kështu që në mënyrë transparente do të dihet se sa është buxhetuar për zbatimin e një plani veprimi për një strategji të caktuar apo për një program të veçantë. Kjo është paraparë edhe në Ligjin e ri për Buxhetin, i cili tashmë është në lexim të dytë në Kuvend në momentin e përfundimit të këtij raporti, i cili do ta zëvendësojë zgjidhjen e vjetër ligjore të vitit 2005<sup>39</sup>.

38 - MIA - 10.3.2022 - Qeveria e RMV-së - Marrëveshje për ndërveprim ndërmjet Md-së dhe institucioneve të tjera (në dispozicion në <https://bit.ly/3MHYHCj>)

39 - Kuvendi i RMV-së - 3.2023-Propozim-ligj për Buxhetin- (<https://www.sobranie.mk/materialdetails.nsp?materialId=601475ec-d636-4fe2-bb60-f557a6178b9e>)

Sipas një eksperti tjetër, megjithatë, jo gjithmonë gjithçka varet nga mjetet financiare:

**"Ndonjëherë gjërat nuk varen vetëm nga mjetet financiare, por edhe nga vullneti i drejtuesve të institucionit. Keni shembuj ku institucionet apo komunat me buxhete relativisht modeste kanë ecur përpara në këtë proces dhe anasjelltas. Përkundër buxhetimit, proceset kanë mbetur në vend ose janë zhvendosur shumë pak"** - thotë eksperti.

Sipas një eksperteje, mund të llogaritet edhe matematikisht se sa do të kushtonte përparimi në shërbimet digjitale. Nisur nga analiza e ekspertes se digjitalizimi i grupeve të të dhënave kushton nga 20 deri në 50 mijë euro, nëse marrim një vlerë mesatare prej 25-30 mijë euro, digjitalizimi i një shërbimi do të kushtonte përafërsisht njësoj, megjithëse ka shërbime për të cilat nuk ka nuk na duhen aq para, por vetëm një lidhje me portalin qendror.

Ajo që mund të konkludohet nga ekspertët në fokus grupin për suksesin dhe përshpejtimin e digjitalizimit në administratë, dhe rrjedhimisht, përshpejtimin e procesit të shërbimeve elektronike, mund të sistematizohet në katër pika apo drejtime të cilat duhet t'i kenë parasysh hartuesit e politikave:

- të ketë vazhdimësi të politikave;
- korniza ligjore duhet të përditësohet vazhdimisht ose të eliminohen dobësitë e vërejtura;
- ndërtimi i infrastrukturës në nivel qendror dhe lokal, në mënyrë sa më të barabartë dhe të sinkronizuar;
- trajnime të vazhdueshme të administratës publike si nga aspekti i edukimit digjital ashtu edhe nga aspekti i zbatimit të shërbimeve digjitale për qytetarët.

Të dhënat e fundit të marra gjatë përgatitjes së këtij raporti janë se i gjithë procesi është i koordinuar nga Kabineti i Ministrisë për Qeverisje të Mirë, ndërsa për nevojën për harmonizim të ligjeve deri më tani janë evidentuar afro 300 ligje dhe dispozita të tjera.

## Fondacioni “Metamorfozis”

### Monitorimi i procesit të eurointegrimi

**Përmbledhje e shkurtër e shkallës së reformave në tre fusha: reformat në fushën e të drejtave themelore të njeriut, reformat në drejtësi dhe reformat në sektorin e medias**

## PROCESI I REFORMËS NË FUSHËN E TË DREJTAVE THEMELORE DERI NË FUND TË MARSIT TË VITIT 2022.

Propozimi për ndryshime dhe plotësime në Ligjin për Evidencën Amë<sup>40</sup>, e cila është dorëzuar në Parlament në prill të vitit 2021, dhe tema kryesore e ndryshimeve të së cilës është identiteti gjinor, është një nga ndryshimet e fundit të rëndësishme që kanë ndodhur në periudhën raportuese nga fundi i dhjetorit të vitit 2021 deri në fund të marsit të vitit 2022.

Me këtë ligj, përkatësisht me ndryshimet dhe plotësimet e tij, u desh të bëhen ndryshime në përcaktimin e politikës gjinore në evidencën amë, në mënyrë që edhe ata persona që nuk e kanë ndryshuar gjininë fizike, do të mund ta shprehin ndryshe gjininë e tyre, gjegjësisht si meshkuj, femra ose persona transgjinorë. Propozimi për ndryshimin e këtij ligji është me kërkesë të disa organizatave joqeveritare që merren me mbrojtjen e të drejtave gjinore dhe themelore të njeriut. Vetë propozimi është shpjeguar mirë nga ligjvënësi, i cili i rendit pothuajse të gjitha arsyet pse kërkohet ndryshimi i këtij ligji, duke filluar nga konventat ndërkombëtare të nënshkruara nga RMV-ja e deri te aktgjykimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg, edhe pse në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) nuk janë të përfshira këto të drejta në mënyrë eksplicite, por për shkak të aktgjykimeve të nxjerra nga kjo gjykatë nga viti 2015 e në vazhdim, RMV-ja është e detyruar t'i njohë dhe t'i zbatojë këto edhe në qarkullimin juridik të brendshëm.

Në momentin e mbylljes së këtij raporti, ligji, i cili prej disa ditësh ishte vënë në rendin e ditës së Komisionit për Legjislacion për lexim të parë me flamur evropian, u tërhoq nga Qeveria e RMV-së dhe sipas deklaratave në dispozicion, ai duhet të përpunohet përsëri, të hapet një debat më i gjerë publik dhe do të kalojë në procedurë të rregullt parlamentare. Shkak për këtë është bërë kundërshtimi i madh i partive politike në Kuvend. Të gjitha partitë opozitare e kundërshtojnë miratimin e tij në këtë formë. Edhe pse mendohej se kishte mbështetjen e LSDM-së në pushtet dhe të shumicës së partive më të vogla në koalicionin qeverisës, në fund doli se as LSDM-ja nuk e kishte mbështetjen e plotë, kurse partneri shqiptar në koalicion - BDI-ja, edhe pse heshti deri ditën e fundit, rezultoi se e kundërshton një ligj të tillë. Arsyetimet janë të ndryshme. Partitë në pushtet këmbëngulin se ligji duhet të miratohet për shkak të shqetësimeve përr buxhetin, i cili do të pësonte nga humbjet e gjykimeve para Gjykatës së Strasburgut, si dhe për shkak të zbatimit të këtyre aktgjykimeve në legjislacionin e vendit, por se do të ketë nevojë për procedurë të rregullt dhe debat më të gjerë. Nga ana tjetër, partitë opozitare thuan se të gjitha kanë dalë me qëndrime konservatore në kuptimin se një ligj i tillë e cenon kuptimin tradicional të familjes dhe martesës, pasi një ndryshim i tillë në ligj do t'i hapte rrugën një ndryshimi të Ligjit për Familjen, ku martesë përkufizohet si bashkësi ligjore midis një burri dhe një gruaje, d.m.th. midis gjinive të ndryshme.

Propozimi për vendosjen e këtij ligji me flamur evropian është shpjeguar me një aktgjykim të Gjykatës së Strasburgut ndaj një personi nga RMV-ja i vitit 2019 dhe bazuar në Rekomandimet e Ministrave të Këshillit të Evropës për luftën kundër diskriminimit të vitit 2010.

E sigurt është se ky ligj për momentin ka mbështetjen vetëm të Grupit Parlamentar Ndërpartiak për mbështetjen e personave që i përkasin komunitetit LGBT, ku përfshihen përfaqësues të disa partive më të vogla në bllokun qeverisës maqedonas.

40 - Kuvendi i RMV-së - Propozim për ndryshime dhe plotësime në Ligjin për Evidencën Amë - mars 2022 - (në dispozicion në <https://www.sobranie.mk//materialdetails.nspcx?materialId=09424067-36fb-4b7c-9853-d4c35ba5a28f>)



Ndryshimi kryesor i propozuar nga ligji është përkufizimi i identitetit gjinor:

"Identiteti gjinor është përjetim i brendshëm dhe individual i gjinisë së çdo personi, i cili mund ose nuk mund të korrespondojë me gjininë e përcaktuar në lindje, duke përfshirë ndjenjën personale për trupin dhe manifestime të tjera të gjinisë, si p.sh. emri, veshja, të folurit dhe sjelljet.

"Njohja ligjore e gjinisë" është një procedurë në të cilën një individ mund ta ndryshojë shenjën për gjininë në evidencën amë dhe në këtë mënyrë njihet identiteti gjinor."

Kjo çështje, e cila e kërcënon komunitetin e gjerë me një ndarje të re, është vetëm maja e ajsbergut, e cila, nëse futemi më thellë, tregon se hendeku gjinor në RMV është ende një pengesë e thellë që duhet trajtuar.

Edhe pse RMV-ja e ka nënshkruar shumë kohë më parë dhe e zbaton në praktikë që para disa vitesh, të ashtuquajturën Konventa e Stambollit të Këshillit të Evropës, dallimet gjinore shihen në praktikën e përditshme. Duke filluar nga ajo se megjithëse gratë kanë arsim të njëjtë ose më të lartë se burrat, pjesëmarrja e grave në pozita udhëheqëse, si në biznes ashtu edhe në sektorin publik është shumë më e ulët. Zgjedhjet e fundit lokale të mbajtura në vitin 2021 treguan se vetëm katër gra kandiduan për 81 mandate për kryetar komune, gjë që tregon se gratë e kanë të vështirë për të depërtuar edhe në veprimin politik të partive, dhe kjo shihet në përbërjen aktuale të Qeverisë së RMV-së, ku pjesëmarrja e grave është vetëm 20 për qind. Sikur të mos ishin kuotat e detyrueshme, ky numër do të ishte i vogël edhe në Kuvendin e RMV-së. Kjo diferencë është reflektuar edhe në arsimin e lartë, ku nuk ka rektore femër, e po ashtu edhe numri i grave dekane është i vogël. Këto dhe shumë të dhëna të tjera u publikuan së fundmi nga "Portalb"-i, "Vërtetmatës"-i dhe "Meta" në një hulumtim që e konfirmon hendekun e madh gjinor dhe i justifikon kritikën për këtë çështje që gjenden në raportet e fundit të KE-së.<sup>41</sup>

Shtyllat kryesore institucionale për mbrojtjen operacionale të të drejtave themelore të njeriut në vend mbeten dy institucione. I pari është Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi (KPMĐ) i formuar vitin e kaluar (2021), në bazë të Ligjit të ri për Parandalimin e Diskriminimit të miratuar në vitin 2020. Komisioni prej shtatë anëtarësh (përkatesisht 6, sepse një nuk është zgjedhur ende) ka kompetenca dukshëm të gjera që i janë dhënë me ligj, por edhe një sfidë se si ta zbatojë atë shpejt dhe pa mbështetjen e plotë të shtetit, megjithëse vetë KPMĐ-ja e pranon se ka marrë ndihmë gjatë këtij viti si nga shteti ashtu edhe nga OSBE-ja dhe nga sektori i OJQ-ve përmes Programit Britanik për Mbështetje dhe Zhvillim. Në vitin 2022 është vënë në funksion edhe ueb-faqja e Komisionit, e cila mundësoi dorëzimin më të lehtë të aplikacioneve elektronike (<https://kszd.mk/>).

Duke i parë arritjet njëvjeçare të Komisionit, mund të konstatohet se ky organ që sipas përkufizimit është i pavarur, e arsyetoi plotësisht besimin e publikut dhe kompetencat e mëdha që ia jep ligji, e për të cilën më meritore është mënyra e zgjedhjes së Komisionit përmes një debati të hapur parlamentar dhe prezantimi publik i programeve dhe i aftësive të kandidatëve të atëhershëm. Sipas statistikave të paraqitura në Raportin Vjetor<sup>42</sup> të KPMĐ-së, deri në fund të vitit 2021, pra për një periudhë 6-7 mujore, që nga koha kur Komisioni ka punuar efektivisht, ka vepruar për 167 ankesa, 77 prej të cilave janë të trashëguara nga përbërja e mëparshme e atij organi, i cili nuk funksiononte më parë. Komisioni ka marrë 90 parashtresa të reja që kur është formuar, duke treguar se besimi në këtë organ është në rritje, dhe deri në fund të marsit, ai ka hapur edhe disa raste në bazë të gojëdhënave, me ç'rast duhet të theksohen rastet që lidhen me lëvizjen fetare Lev Tahor dhe rastin e diskriminimit të një vajze me nevoja të veçanta arsimore nga një shkollë në Gostivar, i cili është ende në vazhdim. Sa i përket parashtresave, ato vijnë më shumë nga meshkujt sesa nga femrat, kryesisht nga Shkupi, kurse baza më e zakonshme është statusi personal dhe statusi shoqëror. Deri në fund të vitit 2021, Komisioni "ka konstatuar diskriminim në 40 raste, ndërsa në 39 është konstatuar se nuk ka bazë për diskriminim. Për 10 parashtresa Komisioni ka nxjerrë konkluzion për mosveprim, mosfillim apo ndërprerje të procedurës, ndërsa 41 parashtresa janë refuzuar për shkak të konstatimit të moskompetencës, parregullsisë, vjetërsimit dhe papranueshmërisë. Për 37 parashtresa procedura është në vazhdim dhe janë regjistruar si lëndë të hapura" (fq. 22 e Raportit Vjetor).

41 - Portalb/Vërtetmatës - mars 2022 - Hendeku gjinor në RMV: burrat dominojnë tregun e punës ...- (në dispozicion në <https://vistinomer.mk/rodoviot-jaz-vo-rsm-mazhite-dominiraat-na-pazarot-na-trudot-i-so-povisoki-plati-bri-sel-ostanuva-kritichen/>)

42 - KPMĐ - mars 2022 - Raporti Vjetor 2021 - (në dispozicion në <https://bit.ly/36I5onG>)

## KPMD KA KËRKUAR NJË BUXHET DERI NË 730 MIJË EURO, MIRËPO KA MARRË MË PAK SE 250 MIJË

Megjithatë, sfidat me të cilat përballlet ky organ mbeten, mbi të gjitha në aspektin organizativ dhe në zbatimin e vendimeve të tij. Më pak se gjysma e vendeve të punës janë plotësuar sipas sistematizimit të vetë Komisionit (29 vende pune dhe vetëm 10 nëpunës administrativë të marrë nga institucione të tjera), që punojnë në 2 sektorë që mbulojnë 4 departamente të sistematizuara, me buxhet të shtetit, i cili është për gjysmë e më shumë më i ulët se nevojat e identifikuar nga vetë Komisioni. Së fundi, kryetarja e parë e Komisionit, Vesna Bendevska, deklaroi se Ministria e Financave nuk ka shprehur interesim për kërkesën e Komisionit, e as trupi punues në Kuvend, përgjegjës për financim dhe buxhet nuk ka treguar interesim, kështu që nga buxheti i kërkuar prej 730 mijë euro për një vit, për vitin 2021 është përcaktuar buxheti prej 15,3 milionë denarë (më pak se 250 mijë euro) ose vetëm 120 mijë denarë më shumë se vitin e kaluar<sup>43</sup>. Gjithashtu, Komisioni është i vendosur në ish-ambjentet e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, të cilat nuk ofrojnë qasje për personat me aftësi të kufizuara fizike. Në Raportin Vjetor dërguar Kuvendit, KPMD-ja paraqet edhe rekomandime që i referohen ndryshimeve në ligj dhe zgjedhjes së anëtarit të mbetur të Komisionit, në mënyrë që ai të kompletohet me 7 anëtarë.

## AVOKATI I POPULLIT ME RRETH 3.000 PARASHTRESA PËR VITIN 2021.

Zyra e Avokatit të Popullit, institucioni i dytë kryesor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve, pak para përfundimit të këtij raporti, më 29 mars 2022, në një konferencë për shtyp i prezantoi të dhënat bazë nga Raporti Vjetor për vitin 2021.

Sipas informacioneve që i paraqiti Avokati i Popullit, në vitin 2021 janë pranuar/regjistruar 2.686 parashtresa, ndërsa nga viti paraprak janë bartur 389 parashtresa ose janë regjistruar gjithsej mbi 3.000 lëndë. Me këtë rast, më të shumtat kanë qenë në fushën e drejtësisë - 436 parashtresa ose mbi 16 për qind, pasuar nga parashtresat në fushën e të drejtave të fëmijëve, 254 parashtresa, në vendin e tretë kanë qenë parashtresat për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve, 228 parashtresa, pastaj sa i përket të drejtave të punës, 218 parashtresa, në fushën e mbrojtjes sociale 183 parashtresa, në fushën e punës së institucioneve ndëshkuese-korrektuese dhe edukative 162 parashtresa, në fushën e të drejtës së pronës 150, në fushën e urbanizimit dhe ndërtimitarisë 136 parashtresa dhe parashtresat e tjera janë nga fusha të tjera<sup>44</sup>.

Nga 3.075 parashtresa të pranuar, Zyra e Avokatit të Popullit ka vepruar në lidhje me 2.085 lëndë ose 67.80 për qind, dhe në 755 prej tyre janë konstatuar shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe është intervenuar për eliminimin e këtyre shkeljeve - thuhet në konferencën për shtyp. Me këtë rast, në 500 raste organet kompetente kanë vepruar në bazë të intervenimit të Avokatit të Popullit, në 233 Avokati i Popullit është dashur të ndërhyjë në mënyra të tjera tek organet më të larta, ndërsa në 23 lëndë ende është në pritje të përgjigjes nga institucioni apo organi kompetent.

Para këtij raporti vjetor, nga hulumtimi i "Vërtetmatësit" në kuadër të projektit, mund të nxirreshin disa konkluzione me specifikat për të cilat foli Zyra e Avokatit të Popullit:

"Gjatë viteve të fundit, situata është pothuajse identike me disa përjashtime. Shumica e parashtresave i referohen fushës së drejtësisë, e cila e përfshin punën e gjykatave, prokurorive, por edhe të noterëve dhe përmbauesve, e ndjekur nga të drejtat e konsumatorëve (ofrimi i rrymës elektrike, uji, ngrohja qendrore), marrëdhëniet e punës, të drejtat e mbrojtjes sociale, të drejtat e fëmijëve.

Kur flasim për gjyqësorin, ndryshe nga dhjetë vjet më parë, kur qytetarët i drejtoheshin Avokatit të Popullit me kërkesë për ndërhyrje në vendimet e gjykatave (për të qenë plotësisht të saktë dhe vitin e kaluar kemi pasur parashtresa të tilla), gjë për të cilën institucioni nuk ka kompetencë, tani kjo ka ndryshuar. Pra, pjesa më e madhe e parashtresave kanë të bëjnë me punën e përmbauesve në të gjitha segmentet,

43 - "Win-win"/TV "Telma" - mars 2022 - Deklaratë e Vesna Bendevska - (në dispozicion në <https://www.youtube.com/watch?v=gS2R4po7bu0>)

44 - Avokati i Popullit - 29.3.2022 - Konferencë shtypi e Avokatit të Popullit të RMV-së - (në dispozicion në <https://bit.ly/3NuMgdp>)

mosrespektimin e parimit të gjykimit në afat të arsyeshëm, sidomos në kontestet e punës, si dhe punën e gjykatave administrative "Gjykatës Administrative dhe Gjykatës së Lartë Administrative" - deklaruan nga Zyra e Avokatit të Popullit [në storjen e "Vërtetmatës"-it](#) publikuar në fillim të marsit të vitit 2021.

Një muaj më parë, në fillim të shkurtit, Avokati i Popullit, Naser Ziberi, njoftoi opinionin se është bërë analiza e veprimeve ndaj vendimeve apo udhëzimeve të Zyrës së Avokatit të Popullit. Ata zbuluan se "rreth 30 për qind e autoriteteve veprojnë në kohën e duhur, 30 për qind i përgjigjen kërkesës së përsëritur dhe 30 për qind nuk përgjigjen fare. Ziberi më pas tha se më pak bashkëpunues janë gjyqësori dhe aparati i detyrimit në vend, i cili ndihet i fuqishëm dhe nuk dëshiron kontroll. Mospërgjigja në kërkesën e Avokatit të Popullit konsiderohet si pengesë e punës së Avokatit të Popullit", tha Ziberi gjatë një paraqitjeje emisionin "Utrinski brifiing", ueb-televizionit i gazetës "Sloboden pečat".

Zëvendës Avokati i Popullit, Suzana Saliu, nga ana tjetër, në [në një emision të TV "Telma", më 9 Mars 2022](#), tha se Zyra ka shumë probleme, përkatësisht ankesa për punën e Drejtorisë për Udhëheqjen e Librave Amë (DULA). Ajo sqaroi se ankesat janë edhe për kërkesën dhe dorëzimin elektronik të dokumenteve dhe për dokumentet që kanë të bëjnë me personat e vdekur, por edhe me shtetësinë. Bëhet fjalë për qindra qytetarë, të cilët presin verifikim për marrjen e nënshtetësisë, si dhe për problemin me rreth 900 qytetarë që kanë dy numra amë.

## REDUKTIM I PËRHERSHËM I BUXHETIT - TENDENCË NDAJ INSTITUCIONIT TË AP-SË?

Por, ajo që është me të vërtetë simptomatike për Zyrën e Avokatit të Popullit në periudhën raportuese nga dhjetori deri në mars 2021/2022, por edhe përgjithësisht si krahasim për dy vite buxhetore, është pretendimi për një ulje jo të vogël të mjeteve të ofruara nga shteti për funksionimin e këtij institucioni. Përkatësisht, Avokati i Popullit Ziberi në konferencën për media tha se buxheti i tij është reduktuar kumulativisht për 30 për qind në krahasim me vitin 2020.

"Unë dhe ministri i Financave jemi në konflikt të përhershëm për çështje elementare, nuk kemi mjete për të kryer aktivitete. Kjo është e palejueshme. Për vitin 2021 buxheti është ulur për 10 për qind nga viti i kaluar. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me rebalancin e buxhetit në gusht, ndërsa buxheti për vitin 2022 është 10% e tij. Për 1 vit buxheti është zvoëgluar për 30 për qind. Këtë e shoh si tendencë për të ngulfatur institucionin", tha Ziberi<sup>45</sup>.

Megjithatë, nga rishikimi në Buxhetin e vitit 2022<sup>46</sup> nuk mund të fitohet kjo përshtypje. Përkatësisht, në ndarjen 31101 të Buxhetit thuhet se për vitin 2021 shpenzimet e përgjithshme të institucionit APishin 81.755 milionë denarë (1,327 milionë euro), ndërsa për vitin 2022, 85.600 milionë denarë (1,390 milionë euro) ose rreth 63 mijë euro më shumë. Natyrisht, kjo rritje minimale nuk do të thotë se do të mbetet, duke pasur parasysh rebalancin e paralajmëruar dhe rialokimin e fondeve për të përballuar shumicën e krizave në të cilat ndodhet RMV-ja, por tregon se pretendimi për një tendencë për të ngulfatur AP-në duhet të vlerësuar me kujdes dhe kjo do të bëhet nga Fondacioni Metamorfozis dhe projektet e tij mediatike për raportin e ardhshëm tremujor të projektit.

Nga aspekte të tjera që lidhen me të drejtat e njeriut në periudhën raportuese nga dhjetori i vitit 2021 deri në fund të marsit të vitit 2022 vlen të theksohet se në fund të muajit shkurt, Koalicioni "Margjinat" e prezantoi raportin e monitorimit për periudhën 2019 - 2021 për mënyrën e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen Sociale në fushën e shërbimeve sociale. Teksti, siç u tha në prezantim, e vlerëson funksionalitetin e shërbimeve ekzistuese të mbrojtjes sociale, duke iu referuar zbatimit të Ligjit ekzistues për Mbrojtje Sociale dhe funksionalitetit të qendrave për punë sociale dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve sociale. Teksti fokusohet në tre grupe të synuara, përkatësisht romët, gratë viktime të dhunës dhe personat me aftësi të kufizuara, të cilat për shkak të pozitës së tyre specifike në shoqëri, për çdo ditë përballen me diskriminim dhe pamundësi për t'u integruar në shoqëri dhe janë kryesisht të varur nga transferimet sociale. Janë evidentuar dobësitë e qendrave për mbrojtje sociale, duke filluar nga ato infrastrukurore e

45 - Alsat TV/ueb - 30.9.2022 - Ziberi akuzon qeverinë se dëshiron ta ngulfasë... (në dispozicion në <https://alsat.mk/mk/ziberi-obvinuva-deka-vlasta-saka-da-ja-zadushi-institutsijata-pravobranitel/>)

46 - Kuvendi i RMV-së - dhjetor 2021 - Materialet e mbyllura / Propozim-buxheti për vitin 2022 - (në dispozicion në <https://www.sobranie.mk//materialdetails.nsp?materialId=60a3a254-9fc0-4ff1-b0b2-4c009a2073c6>)

deri te personeli dhe janë dhënë një sërë rekomandimesh për përmirësimin e punës së tyre, duke përfshirë zhvendosjen territoriale të qendrave të caktuara ose përfshirjen, gjegjësisht zgjerimin e iniciativës private dhe qytetare për të ofruar disa lloje të shërbimeve sociale dhe përfshirje më të madhe të vetëqeverisjes lokale në ofrimin e shërbimeve përmes qendrave për mbrojtje sociale<sup>47</sup>.

## PROCESI I REFORMËS NË FUSHËN E DREJTËSISË, SITUATA DERI NË FUND TË MARSIT TË VITIT 2022

Ekziston një kornizë strategjike për reforma në drejtësi dhe ajo është miratuar në vitin 2017 me vlefshmëri deri në vitin 2022, së bashku me planin e veprimit për zbatimin e tij. Gjithashtu, ekziston edhe një Strategji për TIK-un në gjyqësor për periudhën 2019-2024 dhe një Strategji e Komunikimit për Ndihmë Juridike Falas, e miratuar në vitin 2020. Ajo që është konkluzion më i ri në periudhën raportuese është se, ashtu si Strategjia e Reformës së Administratës, përgatitjet për Strategjinë e re të Reformës në Drejtësi duhet të nisnin me kohë, para verës së këtij viti për të arritur në fund të nëntorit 2022 me strategjinë e re që do të jetë e vlefshme dhe do të aplikohet menjëherë nga fillimi i vitit të ardhshëm 2023.

Për sa i përket ligjeve, megjithëse pothuajse të gjitha ligjet e rëndësishme ose ndryshimet e tyre janë miratuar në fillim të vitit 2021, ekziston nevoja për miratimin e ndryshimeve të reja ose për ndryshime në ligjet ekzistuese, duke i përfshirë edhe ato kryesore: Kodi Penal, Ligji për Procedurën Penale, Ligji për Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë, Ligji për Ekspertizën, etj.

Ajo që mund të veçohet si informacion i ri për periudhën nga dhjetori 2021 deri në mars 2022 është se grupet punuese që i përgatisin ndryshimet në LPP dhe KP punojnë me një dinamikë të caktuar që do të përcaktohet si e kënaqshme, por se materia është tepër e madhe, kurse diskutimet janë të hollësishme, andaj ndryshimet në këto ligje nuk pritet të jenë shumë shpejt gati. Të pyetur për një vlerësim, disa ekspertë thanë se ndryshimet në KP mund të jenë gati dhe më shpejt (deri në verë ose gjatë verës), dhe se përgatitjet për ndryshimet në LPP do të shtyhen deri në tremujorin e tretë, e ndoshta edhe në tremujorin e katërt të vitit 2022.

Për Ligjin për Ekspertizën, debati publik ka përfunduar dhe pritet që të kalojë në Qeveri për t'iu dërguar Kuvendit për procedurë miratimi. Ligji i rëndësishëm për ndryshime në ligjin aktual për Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë ka disa muaj që është gati, ka hyrë, por edhe ka ngecur në Kuvendin e RMV-së, sepse ka pasur kundërshtime të mëdha të opozitës që ligji të miratohet me flamur evropian, gjegjësisht me procedurë të shpejtë. Ky ligj aktualisht është në fazën e leximit të parë. Që situata të jetë edhe më brengosëse, gjenerata e re e pjesëmarrësve në Akademinë prej rreth 90 kandidatësh për gjyqtarë dhe prokurorë të ardhshëm nuk ka filluar ende mësimin për arsye teknike, përkatësisht procedurat e ankimit etj., megjithëse njohuritë e fundit janë se ky proces tashmë ka përfunduar dhe se mësimi duhet të fillojë së shpejti. Ajo që është progres në kornizën ligjore është se Ligji i ri për Procedurën Kontestimore tashmë është në procedurë në Kuvend. Për këtë, një nga ligjet kyçe në gjyqësor, ka pasur kërkesë që të miratohet edhe në raportin e fundit të Bashkimit Evropian nga tetori i vitit 2021.

Situata me Akademinë, gjegjësisht ajo të jetë e vetmja mënyrë për të promovuar gjyqtarë dhe prokurorë të rinj, pritet ta përkeqësojë edhe më tej situatën me gjyqtarët dhe prokurorët e nevojshëm në gjyqësor në vend. Si gjyqësori ashtu edhe ato prokuroria po përballen me mungesën e dhjetëra e qindra gjyqtarëve dhe prokurorëve, gjë që u shpjegua në detaje në raportet e mëparshme të "Metamorfozis". Gjithashtu, ndryshimet në Ligjin për Marrëdhëniet e Punës me të cilat në pension do të dilet detyrimisht në moshën 64 vjeç për burrat dhe 62/64 për gratë, pa përjashtim, e që do të hyjnë në fuqi në fund të qershorit të vitit 2022, do të shkaktojnë një largim të ri dhe gjyqtarëve dhe prokurorëve, por edhe të stafit profesional dhe të gjyqtarëve porotë. Kryetari i Këshillit Gjyqësor [e ka theksuar tashmë këtë në publik](#), aq më tepër që në fund të qershorit të këtij viti u skadon afati i pensionimit tre anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, kurse mandati i tyre zgjat deri në fund të vitit 2022.

Sa i përket çështjes së pavarësisë së gjyqësorit dhe prokurorisë, edhe pse supozimi se ajo është e garantuar me ligjet ekzistuese, siç kemi raportuar në raportet e mëparshme, mbetet çështje debati dhe dyshimi në të

47 - Rrjeti i Mbrojtjes nga Diskriminimi - Raporti i monitorimit ....- (në dispozicion në [http://coalition.org.mk/wp-content/uploads/2022/02/ZSZ\\_GolemDokument\\_WEB\\_v002.pdf](http://coalition.org.mk/wp-content/uploads/2022/02/ZSZ_GolemDokument_WEB_v002.pdf))

gjithë procesin në praktikë, përkundër ligjeve. Një çështje e cila është rihapur me gjithë kompleksitetin e saj, për të cilën publiku ishte dëshmitar, është zgjedhja e fundit e disa prokurorëve publikë në Prokurorinë për Ndjekjen e Krimit të Organizuar. Për zgjedhjen e 5 prokurorëve të rinj aplikuan 10 kandidatë. Për të përfunduar procesi u nevojitën madje tre përpjekje për të mbajtur një seancë të Këshillit të Prokurorëve Publikë dhe deklarata kundërthënëse në publik se pse disa prokurorë kaluan, kurse disa të tjerë me nota më të larta ose po aq të larta nuk u zgjodhën. Por, ajo që është padyshim ndryshe është se ky institucion, i cilësuar nga ekspertët si një ndër më pak transparentët për sa i përket punës së tij, pas seancës ku u diskutua për zgjedhjen/vazhdimin e mandatit të 5 prokurorëve në PTHP NKOK, në ueb-faqen e saj e publikoi procesverbalin e seancës së 47-të<sup>48</sup> nga e cila shihet se problemet janë shumë më të thella se sa që ka qenë e njohur deri tani për publikun. Në fakt, sipas këtij procesverbali, padyshim se ka një konflikt në mes të Këshillit dhe Shefes së Prokurorisë për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, Villma Ruskovska. Nga procesverbali rezulton se madje ka pasur edhe propozime për sanksione disiplinore të Ruskovskës për shkak të deklaratave të saj publike se Këshilli është fajtor që prokuroria është lënë të punojë vetëm me 5 prokurorë, megjithëse sipas procesverbalit shumë nga arsyet i vetë shefes së PTHP NKOK, për shkak se ishte vonuar me vlerësimet për prokurorët, e po ashtu ka dhënë vlerësime të palogjikshme në lidhje me përshkrimin në formularët e vlerësimit, kështu që në mbledhjen e Këshillit disa prokurorëve iu rritën notat.

Një debat i tillë, sipas ekspertëve të konsultuar për këtë raport, konfirmon se në sistemin e Prokurorisë Publike ka probleme më të thella se sa që ka pasur njohuri deri më tani publiku, por sipas mënyrës së zgjedhjes së prokurorëve, tregon edhe për vazhdimin e dyshimeve se paraprakisht është rënë dakord se kush do të zgjidhet/rizgjidhet dhe kush jo. Aq më tepër që në KPPRM, për shembull, sipas informacioneve jozyrtare, por mjaft të besueshme, kanë pasur praktikë që të mbajnë kolegji me para seancave zyrtare në të cilat janë dakorduar qëndrimet para se të mbahej zyrtarisht seanca<sup>49</sup>.

Sa i përket transparencës së institucioneve nga gjyqësori, mbetet vlerësimi mbetet se ajo është e ndryshme në gjyqësor dhe në prokurori, por gjithsesi si institucioni më i mbyllur për publikun është evidentuar KPPRM-ja. Seancat e këtij organi, sipas ekspertëve, ndonjëherë caktohen "sot për nesër", gazetaret kanë ende qasje relativisht të kufizuara, me arsyetimin për hapësirën e vogël për mbajtjen e seancave, dhe vetë seanca nuk mund të ndiqet me kamera. Ajo që përbën një hap në përmirësimin e situatës është përmirësimi i ueb-faqes së KPPRM-së dhe publikimi i procesverbaleve të seancave, si dhe gjithnjë e më shumë materiale apo dokumente të tjera që lidhen me punën e këtij organi.

Që nga periudha e fundit e raportimit, ka pasur një përmirësim në aspektin e transparencës së Këshillit Gjyqësor, e cila edhe ishte shumë më e mirë se ajo e Këshillit të Prokurorëve Publikë, si ndaj publikut ashtu edhe për sa i përket proceseve thelbësore të kryera nga ky organ suprem që e menaxhon gjyqësorin në RMV. Vazhdon kompletimi i organeve të brendshme për përzgjedhjen e gjyqtarëve në gjykata më të larta dhe i dispozitave të brendshme, siç është "vendimi për përcaktimin e numrit referues të lëndëve që duhet të zgjidhen nga një gjyqtar në muaj, në gjykatat themelore, gjykatat e apelit, Gjykatën Administrative, Gjykatën e Lartë Administrative dhe Gjykata Supreme të RMV-së për vitin 2022", i cili duhej të miratohej në fund të marsit të vitit 2022.

## DIGJITALIZIMI SHTYHET PËRPARA SISTEMATIKISHT

Një proces i reformës në drejtësi që mund të thuhet se po realizohet dhe po ecën për mirë është sigurisht digjitalizimi. Pas vendosjes së një pjese të shërbimeve të gjyqësorit ndaj qytetarëve përmes formës elektronike të ofrimit të këtyre shërbimeve në fund të tetorit të vitit 2021, ka përfunduar edhe procesi i pajisjes digjitale të pesë gjykatave pilot në vend, duke përfshirë edhe sallat kryesore të gjyqit plotësisht të pajisura në mënyrë digjitale. Problemet me tenderimin që ishin të pranishme në fund të vitit 2021 janë tejkaluar, gjykatat janë pajisur apo janë duke u pajisur, së bashku me përmirësime të tjera infrastrukturore. Megjithatë, ndoshta më e rëndësishmja, është se më në fund është zgjeruar lidhja digjitale e gjyqësorit me institucionet e tjera në vend.

Më 10 mars të vitit 2022, në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut u mbajt ceremoni në të cilën Ministria e Drejtësisë nënshkroi marrëveshje për ndërveprim me 9 institucione që nga ai moment mund të komunikojnë drejtpërdrejt me gjykatat. Gjithashtu u tha se në platformën e ndërveprueshmërisë tashmë janë rreth 40 institucione me tendencë që deri në fund të marsit të ketë edhe dhjetëra të tjera. (Më shumë detaje në seksionin për digjitalizimin e administratës më lart në këtë raport). Sipas vlerësimit të një eksperti të komunikuar për nevojat e këtij raporti, përshtypja është se digjitalizimi në gjyqësor po shtyhet në drejtimin e dhur me dinamikë të mirë kohore, ndryshe nga pjesa tjetër e administratës.

48 - KPPRM - Procesverbali i seancës së 47-të - (në dispozicio në <http://sjorm.gov.mk/зaписник-13/>)

49 - Intervistë me një ekspert nga fokus grupi e mbajtur më 23 mars 2022

## PROCESI I REFORMËS SEKTORIN MEDIATIK DERI NË FUND TË MARSIT TË VITIT 2022.

Ashtu siç situata me reformat në sektorin e mediave përgjithësisht ka qenë e pandryshuar gjatë gjithë vitit 2021 krahasuar me vitet e mëparshme, përveçse në fushën e legjislacionit, e njëjta mbetet edhe në tremujorin e parë të vitit 2022. Edhe ai hapi i vogël në kuptimin legjislativ që u bë me ndryshimet e vendosura në Kodin Penal, sipas të cilave sulmi ndaj gazetarit do të interpretohet si sulm ndaj një personi zyrtar, ato ndryshime nuk janë miratuar nga Parlamenti dhe kanë ngecur në procedurë parlamentare.

Sipas ekspertëve të konsultuar për këtë periudhë raportuese, nuk është e qartë pse ky ligj ka mbetur i bllokuar, pasi partitë në Kuvend nuk kanë shprehur asnjë vërejtje apo synim për ta plotësuar atë me ndryshime. Mbetet mundësia që ngecja të ketë ndodhur për shkak të stagnimit të përgjithshëm të Kuvendit me plotësimin me anëtarët të ri të trupave punues, por edhe një debat për ndryshimet me amendamente që është paralajmëruar në lidhje me nenet e KP-së, të cilat ndryshohen në aspekt të përmbushjes së të ashtuquajturës Konventa e Stambollit dhe rritjes së mbrojtjes së grave me futjen e një vepre të re penale - përndjekjeja. Këto ndryshime janë në paketë me ndryshimet e propozuara për rritjen e mbrojtjes së gazetarëve. Mirëpo, në fund të muajit, në rendin e ditës të komisionit parlamentar me flamur evropian, në lexim të parë, u vunë edhe këto ndryshime në KP<sup>50</sup>. Procesi me ndryshimet në Ligjin për Përgjegjësinë Qytetare për Ofendim dhe Shpifje, i cili tashmë është në fazën e leximit të parë, ka ecur pak më tej, duke i rritur kështu gjasat që ndryshimet e këtij ligji të miratohen së shpejti, me të cilat do të ulen në mënyrë drastike dënimet për gazetarët, redaktorët dhe pronarët e mediave nëse kundër tyre zhvillohet procedurë gjyqësore për ofendim ose shpifje.

Ka një ndryshim në periudhën raportuese nga janari deri në fund të marsit të vitit 2022 për sa i përket praktikës gjyqësore dhe ajo është vlerësuar pozitivisht nga ekspertët. Konkretisht, gjatë kësaj periudhe gazetarët apo redaksitë kanë fituar procese gjyqësore që janë ngritur kundër tyre në tre raste nga persona aktualë apo të mëparshëm të zgjedhur apo emëruar, të cilat Këshilli i Europës i karakterizon si padi për SLAP<sup>51</sup> (Strategic lawsuits against public participation-SLAPP). Në të tre rastet, gjykata e mbështeti të drejtën e gazetarit ose të medias për liri më të madhe të fjalës kur bëhet fjalë për një person të zgjedhur ose të emëruar, duke demonstruar kështu, në praktikë, pajtueshmërinë e gjyqësorit me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe me praktikën gjyqësore të Gjykatës për të Drejtat e Njeriut në Strasburg. Megjithatë, në këtë drejtim, thonë ekspertët, duhet pasur parasysh se në të njëjtën kohë me tendencat e këtyre pozitive të gjykatave vendase, ka një numër në rritje të padive nga funksionarë aktualë apo ish-funksionarë apo kompani kundër gazetarëve apo mediave në krahasim me dy-tre vitet e fundit.

Numri i sulmeve ndaj gazetarëve nuk është rritur në tremujorin e parë të vitit. Megjithatë, shoqatat e gazetarëve vërejnë pengesa specifike në punën e gazetarëve nga agjencitë e sigurimit apo madje edhe kërcënim fizik për sulm me sëpatë, një rast konkret që ka ndodhur gjatë raportimit për një ngjarje në rajonin e Tetovës. Organizatat gazetareske, të pyetura për arsyet e këtij problemi, sërish e lidhin me mosmiratimin e ndryshimeve në Kodin Penal për mbrojtje më të madhe të gazetarëve, edhe pse përgjithësisht janë të kënaqur me veprimin e shpejtë të MPB-së, por edhe më tej jo edhe me atë të prokurorive.

Zgjedhja e anëtarëve të rinj të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Audio dhe Audio-Vizuale Mediatike dhe Këshillit Programor të RTM-së, bazuar në konkursin e dytë me radhë të shpallur nga Kuvendi i RMV-së në tremujorin e parë të vitit 2021 edhe më tej mbetet si problem, për të cilin nuk ka njoftime se do të zgjidhet, madje edhe në tremujorin e dytë të vitit 2022. Ekspertët nuk shohin përparim në këtë drejtim, pavarësisht se për një kohë të gjatë arsyetimet nga pushteti ligjvënës dhe ekzekutiv ishin se problemi qëndron në ngecjen e Komisionit për Zgjedhjet dhe Emërimet në Kuvend. Tashmë që ky problem është zgjidhur disa javë më parë, Komisioni nuk e sheh të nevojshme riaktivizimin e konkursit, i cili, për arsye procedurale do të duhet të shpallet i pavlefshëm dhe të shpallet për të tretën herë. Kujtojmë se ky është obligim ligjor i Kuvendit për të plotësuar organet në Agjencinë për Media dhe në RTM. Ekspertët ritheksuan se "janë të sigurt se bëhet fjalë për mungesë të vullnetit politik, i cili, nga ana tjetër, mund të jetë si rezultat i asaj se

50 - Kuvendi i RMV-së - 28.3.2022 - Propozim-ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal - (në dispozicion në <https://www.sobranie.mk/materialdetails.nspx?materialId=4448d2a8-7fc4-4fdc-9c2a-b43443de38c2>)

51 - SHGM - 4.2.2022 - Gjykata hodhi poshtë padinë e Apasievit kundër gazetarëve - (në dispozicion në <https://bit.ly/3ISAXZh>)

dhjetëra kandidatët që aplikuan në këto konkurse për të dy organet, nuk u pëlqenin partive politike. as të opozitës e as të shumicës parlamentare".

Mbeten edhe problemet me paratë publike në media nga dy aspekte. Njëri është shpenzimi i milionave të parave publike për reklamat e partive politike përmes procesit zgjedhor, që mundësohet nga Kodi Zgjedhor. E dyta është financimi i transmetuesit publik RTM, i cili prej vitesh është buxhetuar në një minimum ligjor apo edhe nënligjor, në vend që të zbatohet zgjidhja ligjore për financimin e RTM-së për të arritur nivelin 1% të buxhetit të shtetit që është realizuar në vitin paraprak buxhetor.

Problem është financimi i transmetuesit publik, i cili është zvarritur që nga ndryshimi i legjislacionit në vitin 2017, kur shteti vendosi ta ndryshojë modelin e financimit të RTM/RTN dhe në vend të taksës për radiodifuzion, financimi të bëhet përmes buxhetit të shtetit. Që atëherë e deri më sot, shteti (ligjërish), nuk e përmbush detyrimin e tij për financimin e RTM/RTN përmes sistemit të financimit të përgjithshëm të radiodifuzionit, gjë që tregohet nga shifrat në buxhetin e vitit 2022<sup>52</sup>, ku janë paraparë 900 milionë denarë ose 14,6 milionë euro për të gjithë sektorin, nga të cilat, sipas shpërndarjes ligjore të mjeteve RTM-ja do të marrë pak më pas se 11 milionë euro, që është më pak se në vitin 2021. Në vitin 2021, me rebalancin e korrikut, veprimtaria radiodifuzive është financuar me 1,1 miliardë denarë ose mbi 18 milionë euro.

Për sa i përket përmirësimit të statusit të gazetarëve dhe punës materiale të mediave për ruajtjen e kushteve për një gazetari të pavarur dhe objektive, vlen të theksohen dy procese. I parë është dëbimi i 6 gazetarëve dhe punëtorëve të mediave që ndodhi në fund të vitit të kaluar dhe në fillim të këtij viti, së bashku me mobingun e disa gazetarëve të punësuar dhe punëtorëve të mediave, anëtarë të Sindikatës së Pavarur të Gazetarëve të Maqedonisë nga TV "Alfa", një televizion me koncesion për transmetimin tokësor në të gjithë vendin. Këto procese u zhvilluan pas ndërprerjeve të njëpasnjëshme të procesit të punës në televizion të ndërmarrja për shkak të rrogave të papaguara dhe vonesave të rrogave gjatë gjithë vitit 2021, dhe në të gjitha këto ngjarje punonjësit ishin të udhëhequr nga sindikata lokale, ndërsa mbështetje mori dhe ende e gëzon nga udhëheqësia e SPGPM-së. Nga Sindikata dhe nga të punësuarit dhe të shkarkuarit, vazhdimisht arrijnë pohime dhe dëshmi të reja se bëhet fjalë për një përpjekje për të penguar plotësisht veprimtarinë sindikaliste në këtë medie.

Për sa i përket përmirësimit të gjendjes financiare të gazetarëve, sindikata arriti ta përmirësojë gjendjen për sa i përket statusit të korrespondentëve të RTM-së, fillimisht për pagesën e honorareve të prapambetura, e më pas edhe për kontratat me afat të caktuar, por megjithatë ky proces është ende i vështirë për shkak se lejet e punësimit në RTM janë me miratim të detyrueshëm nga Ministria e Financave.

Procesi i dytë është përpjekja e Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) për ta ripërtërirë dialogun me Qeverinë për themelimin e Fondit për Media, sepse së fundmi, siç thotë një nga ekspertët, po bëhen gjithnjë e më të zëshme kërkesat nga mediat për kthimin e dispozitave të nenit të Ligjit për Shërbimet Audio-Vizuale Mediatike, i cili mundëson reklamimin e qeverisë në media, për shkak të gjendjes së vështirë materiale dhe financiare të botuesve të mediave. Sipas një eksperti, definitivisht është hequr dorë nga iniciativa për themelimin e Këshillit për media në kuadër të dialogut për zgjidhjen e problemeve në sektorin e mediave, e cila është iniciuar vitin e kaluar nën patronatin e MSHIA-së. Mirëpo, për këtë arsye SHGM-ja e ka rinovuar iniciativën për kontakte të drejtpërdrejta me Qeverinë rreth këtij fondi dhe pritet zhvillimi drejt realizimit të kësaj ideje në javët e ardhshme.

52 - Qeveria e RMV-së - 2.12. 2021- Konferencë për shtyp e Jeton Shaqirit, Ministër i MSHIA-së - (në dispozicion në <https://vlada.mk/node/27143>)

